


HEJZA



Visar ZHITI

**NË BURG NUK NA LEJOHEJ KRIJIMI,
ISHTE E NDALUAR TË FRYMËZOHESHE**

Rreth konkursit të sivjetmë letrar "Ora e Astritit"

NË PRITJE TË INTENSIFIKIMIT TË KONKURRENCËS NË POEZI

Edhe përkundër prirjeve evidente të krijuarve për krijimtari poetike, sikur hetohet se mungon një punë më e gjatë dhe sistematike e autorëve

Kemal ALIU

Më 29 shtator 2023, në Ferizaj u mbajt takimi final i edicionit të shtatë të konkursit të poezisë "Ora e Astritit". Në këtë konkurs tradicional, që mbahet në kujtim të poetit dëshmor Astrit Bytyçi, këtë vit juria profesionale e përbërt nga: Kemal Aliu - poet, ish-kryetar i klubit "De Rada", Sabit Rrustemi - shkrimtar, botues, kryetar i Ars Klubit - Gjilan dhe Shkelzen Halimi - redaktor në gazeten elektronike për art dhe kulturë "Hejza" ndau të gjitha shpërbllimet, vendin e I-rë, II-të dhe të III-të. Në lidhje me konkursin e sivjetmë në të cilin arritin mbi 70 poezi, vlen të theksohet se ka një ngritje në aspektin sasior dhe cilësor edhe pse jo të hetueshmë.

Që në fillim të qasjes lëndore të këtij konkursi në lidhje me numrin e përgjithshëm të poetëve konkurrues vërehet se edhe përkundër prirjeve evidente të krijuarve për krijimtari poetike, hetohet se mungon një punë më e gjatë dhe sistematike, gjë që dëshmohet edhe nga disa lëshime teknike dhe logjike, të cilat derivojnë si rezultat i një përkushtimi më pak të theksuar nga ai që e do poezia. Kësaj radhe, do të shprehim disa vlerësimë rreth dy poezeve, që u vlerësuan si më të mirat e këtij konkursi.

Poezia që zuri vendin e parë "Gjinestra" (Xh. Rexhepi), është poezi që e dëshmon një përkushtim të thellë dhe të elaboruar mire artistikisht. Me vdekjen e kryezotit, në motin e mbytur me shira dhe trishtim,



në natën pas të zezë dhe të dominuar nga gjysmëhëna, po niste udhëtimin biblik arbri, duke lënë pas gjurmët identitare të tija në unat e zjarreve që po fikeshin. Si poezi e ndërtuar me një figuracion të dendësuar simbolik, arrin të transmetojë si dhe të reproducjoni në perceptimin e lexuesit nocione tekstuale e intertekstuale, si dhe kuptime nga përmbarësoret për t'u vëmendësuar te unat e zjarrit që në mënyrë të vërvishme do të lidhen nëpërmjet strofave të kangleve, në udhëtimin shekullor me netët kalabreze: (Atdheu dhe toka e huaj). Unat e zjarrit (shenjat identitare nacionale) në njëren anë, dhe netët kalabreze identifikojnë dy brigje, dy pole brenda së cilës

frymon arbri. Poeti do të vazhdoj për të arritur deri në fundin, ku mbrapa këtij udhëtimi të netëve të gjysmëhënës, të këmishëve të përgjakura do të ngelet e përfjetshme, Morea, "Me hije ere", sic thotë poeti dhe me netët e pafundme kalabreze që kuvenojnë dhe kërkijnë me zérin shekullor "Illin e buruk". Është poezi e konceptuar mirë, e një teme ndër më komplekset në letërsinë tonë, shquhet për vargun e disiplinuar dhe përmbarësore kuptimore të begatshme figurative. Gjithashtu edhe poezia tjeter "Kujtimet e fundit" (Sabit Bajraktari), është poezi ku autori ka arritur të trajtësoj në mënyrë artistike fatin e genies rjerëzore të gjendur midis dy polesh; Polit ku shtrihet

jeta (e pabesueshmja) dhe asaj të përtej jetës që është vdekja, dhe që është apriori (e panjohura). Çastet e para vdekjes së babait që i përjeton poeti, janë të rënda përfaktin se ndryshon shkalla e relativitetit. Përderisa te jeta, pabesueshmëria është e relativitetit relativ, te vdekja, e panjohura është relativitetit të gravituar nga absolutja. Në këtë atmosferë të rëndë trishtuese ka vetëm mendime të ftoha dhe është vetëm një portë e shtegdaljes. Ajo e udhëtimit në brendësi të genies, ku aty do e presin kujtimet asht e lëkurë. Shpëtimi do të kërkohet në dehje dhe në tymin e cigares që e çmijegullon shpirtin, duke e kthyer atë në kthjellësni për të kundruar një jetë të tërë, që shndërrrohet në grush, për të pëlcitur dhe shpërndarë trishtimin dhe mërzinë kur vdekja e thotë fjalën e saj të fundit. Është poezi e komunikueshme, që trajton absurdin e vdekjes, shquhet për nga dimensioni emocional, vargu i njëtrajtshëm dhe i drejtpërdrejtë, që e cilëson gradacioni i një ankhë në narracionin ligjërues, i efektshëm për leximin aktiv.

Edhe poezipëtë tjera janë mjaft të mira. Me një fjalë, rreth 30 sosh u vëguan dhe u vlerësuan pozitivisht. I mbetet KL "De Rada" që në të ardhmen të hulumtojë metoda tjera, të cilat do të ishin më të efektshme lidhur me intensifikimin e konkurrencës brenda konkursit letrar, e cila do të gjeneronte me vlera poetike të cilësuara...

Autor i posterit: Drian (Arbëri) Shala

Reagim

NDALOJENI KËTË AVVENTURË!

(Letër e hapur zonjës Alda Bardhyli, drejtoreshë e Shtëpisë së librit)

Sulejman MATO

Të degjova me kujdes në një intervistë televizive, te News 24, duke folur me pasion dhe pa marrë frymë përsukseset e një farë shtëpie libri ku ju, çuditërisht, keni marre drejtimin dhe kompetencat e Lidhjes se Shkrimitarëve të Shqipërisë. Ju dëgjova duke dhënë lajmin e bujshëm, dhe u pataksa, kur mora vesh se ju së shpejti do bëni një shou, do përcaktori laureatin e poezisë bashkëkohore të Shqipërisë dhe, me dernek këtë detyrë të vështire do t'i besoni një komisioni inkongito... Çfarë mjerimi!

Të mendosh ku kemi qenë...Kush ishte Lidhja e Shkrimitarëve dikur, një Institucion i madh e tepër i rendësishëm, më mbi 300 anëtarë, shkrimitarë, artistë, studiues e kritikë të artit dhe ku kemi përfunduar...Te një shtëpi libri e drejtuar nga një zonjë që me sa di unë, nuk

është as shkrimitare, as artiste, as studiuese, as kritike arti, por që zonjë e emëruar nga dikush e qe jo vetëm drejton një shtëpi libri, por afro rreth vetes një klan krijuar me interesë meskine dhe merr kompetencat e përfaqësimit të të gjithë poeteve dhe kritikëve të poezisë shqipe, këndej dhe matanë kufirit, përtë na reklamuar në ditët e para të tectorit laureatin e poezisë bashkëkohore. Çfarë mjerimi!

Po çfarë mendojnë sot qindra poetë të Shqipërisë, brenda dhe jashtë vendit? Ju drejtohem ju, singerish, miq të mi, anëtarë të Lidhjes së dikurshme. Ju drejtohem poetëve të njohur të brezit tim, me botime të shumta poetike: Musa Vyshka, Xhevahir Spahiu, Hiqmet Meçaj, Sadik Bejko, Anton Papleka, Natasha Lako, Visar Zhiti, Rudolf Marku, Skender dhe Mujo Buçpapaj, Petraq Risto, Roland Gjoza, Niko Kacalidha, Vllasova Musta, Vaid Hyzoti, Skend-

er Rusi, Beatrice Ballici, Irma Kurti, Gëzim Hajdari etj poetëve të para nëntëdhjetës.

U drejtohem poetëve të Kosovës, Agim Gjakovës me shokë, i drejtohem brezit më të ri të poetëve që unë i kam njohur, kam bërë recensa dhe parathënie për poezitë e tyre, ju drejtohem poetëve Agim Bajrami, Andi Meçaj, Ismail Xhaferit, Mirela Papuciut, Rita Petros etj. etj që për çastin s'po më bien ndërmend, u drejtohem dhjetëra poetëve të gjallë dhe të vdekur, të përzgjedhur dhe të botuar në kolanën e poezisë shqipe botuar nën kujdesin e SH. B. "Toena", ju drejtohem poeteve te rinj dhe të vjetër, poetëve të shumtë të Kosovës, të Shqipërisë, të Maqedonisë dhe te diasporës...A jeni ju dakord që kjo zonjë e librit të mbledhë një komision (sic lojmëroi) dhe të bëjë një shou të tillë, duke na dhënë laureatin tonë poetik? Po të më pyesni mua, këtë detyre mund t'i besoja vetëm një

shkrimitari të madh, sic e kemi sot midis nesh, fatmirësish, Ismail Kadaresh ose ky vlerësim t'i besohet një jurie poetesh të afirmuar me jo më pak se 12 personalitete poetike. Ose ky gjykim t'i nënshtrohej një opinioni më të gjerë poetesh, kritikesh dhe studiuesish të letërsisë, të cilët i kemi me shumicë.

Përndryshe, zonja Bardhyli, ndalojeni këtë aventurë, se nuk jeni ju dhe juria juaj që do të mund të gjykojë për këtë proces kaq delikat. Poezia shqipe dihet kush është dhe poetët e mirë dihet kush janë dhe nuk kanë nevojë për atë laureatin që kërkoni ta përzgjidhni ju jashtë çdo kriteri të gjykimit të vlerave letrare të poezisë bashkëkohore. Përfundimisht, kur institucioni ynë i dikurshëm zëvendësoshet me një kasolle, sigurisht këto gjëra mund të ndodhin. Dhe për këtë gjë lë të mos akuzojmë askënd, se fajin e kemi vetë ne, shkrimitarët dhe artistët.

Nën thjerrë

REVOLUCIONI I MENDIMIT

Liria humbë domethënien e vet në momentin kur kostumin e identitetit kulturor ta "qepin" militantët partiakë! Platformën e zhvillimit të këtij identiteti ta shtrojnë dibiduzët të cilët janë në gjendje "ta vrasin" me oratorinë e tyre "revolucionariste" çdo kulturolog, çdo intelektual që mund të jetë edhe nderi i kombit

Nga Avni HALIMI

Artistët, përmes artit të vet, gjithnjë e kanë synuar më të mirën e botës! Deri te kjo e mirë artistët kanë hapëruar në dy kahe: në njërin kah artistët janë angazhuar për të qenë sa më të denjë në përfaqësimin e botës (reprezentativ), ndërsa në kahun tjetër kanë qenë artistët ijtihare të transformimit të botës kah më e mira, më e bukura, më dinjitozja! Artistët që e kanë mëtuar dhe që në njëfarrë forme e kanë arritur këtë synim, janë quajtur avangardë. Artistët reprezentativë janë llogaritur ajo avangardë artistësh që në art kanë sjellë stile dhe teknikë (kubizmi, ekspresionizmi, ekspresionizmi abstrakt)! Në periudhën e post-avangardizmit (në shoqëritë që gjakonin një jetë liberale) si dhe në avangardën post-socialiste, do të kemi edhe stile dhe teknika të tjera të cilat hollësish i trajton historia e artit. Kjo avangardë e artistëve reprezentativë mendojnë se përfaqësojnë "artin e pastër" – prandaj nijhen si tipa idealistë! Këta mendojnë se duke i afuar shoqërisë kryevepra, duke u mësuar shoqëria në shijimin e së bukurës së tyre - kësisoj do të arrihet transformimi i botës!

Në anën tjetër, kemi avangardën e cila mëton që përmes artit të vet të dikojë në jetë dhe, me këtë, ta ndryshoje botën. Për shkak të koncepteve të tyre mbi reformimin e botës, ata herë do të quhen si "ekstremistë" e herë si "radikalistë", herë si "revolucionaristë", herë si "politiko-poetikë", e herë si "politiko-estetikë". Këto emrët me përbajtje politike, ndikuan në tipizimin e tyre si lëvizje avangarde "estetike" dhe do të shfaqen pothuajse në çdo shoqëri!

Nevoja për kulturimin e popullit politik

A i kemi ndër ne (ndër artistët shqiptarët) këta lloje avangardistë? Të kuptohemi "avan-gard"-istët gjithnjë duhet të jenë para kohës dhe duhet të dinë saktësish se kah po shkon shoqëria e tyre! Rilindësit tanë e dinin, pa dyshim! Por, nëse i kemi sot këta avangardë, a mund të na thonë se në ç'drejtim (jo-politik) po hapëron shoqëria shqiptare? Janë disa konstatime që mundohen të vërtetojnë se populli shqiptar është populli më politik në rajon! Edhe fëmijët në djep merren me politikë! Para një shekulli e gjysmë, poeti, dramaturgu dhe historiani gjerman, Fridrik Shiler, ngriti teorinë se zgjidhjet politike pa një qasje estetike gjithnjë janë gjysmake dhe, thjesht, të paqëndrueshme. Ai thoshte: "Nëse njeriu dëshiron që përfundimisht t'i zgjidhë problemet politike, ai këtë do të mund ta arrinë vetëm përmes problemit estetik, sepse, njeriu vetëm përmes të Bukurës mund të vije deri te Liria!" Porosi gati të ngjashme si kjo përcjell edhe proverbi popullor irlandez i cili thotë se "Një popull që e ka të kultivuar lirikën ai e do Lirinë! Ky lloj i avangardistëve reformimin e botës e shikon vetëm



përmes "revolucionit estetik"!

Ky është shpjegimi mbi atë se si Shtetësia e Kosovës po del të jetë kaq shumë "rrëfim i suksesshëm"! Sepse, të paktën nga tri dekada para luftës çlirimtare, "revolucioni estetik" është ndjerë pothuajse në çdo vit! Plot një dekade para luftës Lëvizjen Popullore brenda Kosovës e drejtuan "ekstremistët", "radikalistët", "gandistët", "poetët politik", "estetët politik", "krijuesit nacionalistë", pra, një avangardë që po drejtonte në "paqe të okupuar" një "revolucion estetik" deri në dalje në sipërfaqe të "planit B" - të çlirimtarëve të ushqyer edhe me frutat e këtij "revolucioni"! Dhe, ky duhet të jetë shpjegimi edhe i "rrëfimit dësh-përues" të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut! Në njëren anë, angazhimi politiko-luftarak i subjekteve shqiptare dhe, në anën tjetër, këmbëngulja për prezencë reprezentative të elementit misionarist të "ekstremistëve fetarë", e refuzuan nevojën e "revolucionit estetik" duke e llogaritur si "luks përtej kohës", apo edhe si "mëkat i madh"! Prandaj te shqiptarët e Maqedonisë së Veriut "plani B" nuk ishte as "revolucion", as "luftë" por thjesht, protestë "e armatosur" për të "drejtë reprezentative" (të drejtat e shqiptarëve) dhe përfaqësimin adekuat të shqiptarëve në administratën shtetërore dhe publike! I vetmi "transformim estetik" i cili mund t'i karakterizojë sot shqiptarët e Maqedonisë së veriut, është mjerisht "pedantëria" prej të genët "protestues partiake" si dhe "bukuria e mjekëzimit" të misionarëve që shkon përtej identitetit kombëtar!

Shkrimitari dhe historiani hungarez, Miklósh Sabolczi, ndante mendimin se "revolucioni pa avangardë (në art) në fakt është pseudorevolucion"! Përtej këtij realiteti demoralizues, shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut u mbetet vetëm edhe një përpjekje vetëmohuese - revolucioni kulturor, i

cili do të dinte t'i çmonte frytet e "protestës luftarake" kombëtare (2001), duke i transformuar nga "vlera personale" në vlera estetike me forcën e përfjetësisë. Me nozionin "Revolucion Kulturor" në rastin konkret, nuk mendohet në formën e Revolucionit Kinez, apo të Revolucionit Francez, nuk mendohet as në çlirim e në pavarësim, por thjesht mendohet në përkushtimin kombëtar të subjekteve politike që "popullin politik" ta kulturojnë!

Liria e uzurpuar nga "revolucionaristët"

Kur një popull ka nevojë për "revolucion mendimi" (problem i shtruar në një intervistë për HEJZËN nga Sulejman Rushiti, regjisori)? Kur mund të jetë ajo kohë për një konstatim të tillë! Koha e sotshme? Pa dyshim, kur shprehja e mendimi rrjedh nga një "gyp partiake", kur mendimi është i disiplinuar dhe uniform me mendimin e liderit politik, kur ngulfatet mendimi i "fakirit", kur ndrydhet nevoja për shprehje të mendimit alternativ, kur bllokohet fjala e intelektualit, kur shantazhohet intelektuali, kur blihet intelektuali me një post, me një projekt, me një detyrë - ky është ai moment për "revolucion mendimi". Revolucionet shpërthejnë vetëm kur liria është në zgrip të asfiksisë momentale (liria nuk vdes kurrë!) kur jeta humb kuptimin e vet, kur hyjnizohet pushteti politik deri në religjon "që i bën mirë shpirtit"!

Në momente të tilla shpërthen revolucioni dhe me të drejtë pushteti duhet t'u takojë revolucionaristëve. Por, kjo e drejtë humbet në çastin kur revolucionaristët uzurpojnë lirinë! Liria humbë domethënien e vet në momentin kur kostumin e identitetit kulturor ta "qepin" militantët partiakë, ata që në jetën e vet nuk kanë lexuan më shumë se tre tituj librash (pra, jo gjithë librin)! Platformën e zhvillimit të këtij iden-

titeti ta shtrojnë dibiduzët të cilët janë në gjendje "ta vrasin" me oratorinë e tyre "revolucionariste" çdo kulturolog, çdo intelektual që mund të jetë edhe nderi i kombit.

Nëse injoranca është masë tumorale në trup të identitetit kulturor, mediokriteti është kancer i këtij identiteti! Kur të shtrihet përtokë mendimi intelektual atëherë në sipërfaqe ngriten arrivistët, mediokret, pseudomendimtarët, shitësit e dashkut për goglal! Për fat të keq, ky është realiteti anekënd viseve tona etnike, realitet që pasqyrон rikthimin tonë në kohën fishtiane, me një përjashtim esencial: nëse atëbotë të tjerët e shfrytëzonin injorancën tonë për t'u tallur me ne, sot ne e shfrytëzojë injorancën për t'u tallur me vetveten. Në Shqipëri "revolucionaristët" (PS) imposhtën "injorantët" (PD) që "kostumin kulturor" të na e presin anonimusët! Intelektualët kombëtarë duhet të heshtin, sepse, ata duhet ta dinë që, buxheti shtetëror nuk është në duart e tyre! Në Kosovë "revolucionaristët" çliran Kosovën dhe pavetëdije vazhduan avazin e mihiqës në themel të identitetit kulturor. Këta u imposhtën nga "neo-revolucionaristët" (LVV) sa për t'i pensionuar të parët në mihiqë të këtij identiteti. Në Maqedonië e Veriut e gjetiu nëpër viset tona etnike, "revolucionaristët" (BDI) kanë gjetur metodën e bërjes së "kulturës" - duke i heshtur intelektualët! Të gjitha partitë e tjerë, të gjithë "intelektualët" e tubuar nëpër subjekte të tjerë, me t'u dhënë shansi për pjesëmarrje në qeveri, sakaq, bëhen pale edhe të degradimi të identitetit kulturor. Koha është për politikë e jo për kulturë! Për kusht në përfshirje në qeveri nuk shtrojnë zhvillimin e identitetit kulturor por, postet ministre e drejtore e ndryshme! Prandaj, regjisori nga Maqedonia e Veriu, Sulejman Rushiti, në një intervistë në "Hejza" klithë përvajshëm: "Ne kemi nevojë për revolucion mendimi"!

Intervistë ekskluzive me Visar Zhitin, shkrimtar

NË BURG NUK NA LEJOHEJ KRIJIMI, ISHTE E NDALUAR TË FRYMËZOHESHE

Disidenca në letrat shqipe nuk lejohej, prandaj ka nga ata që nuk besojnë apo nuk u duhet ta besojnë se ka pasur disidencë. Meqenëse nuk lejohej, nuk do të thotë se nuk ka qenë. Disidenca në letërsinë shqipe ka qenë e fshehtë, e pa organizuar, vetanake siç është dhe vetë letërsia, guxoi deri në heroizëm dhe u martirizua. Tashmë ajo është një realitet me vepra, një përvojë që i shërben të sotmes dhe të ardhmes, do të jetë deri sa të ketë pushtete mbi të, në mbrojtje dhe në emër të së bukurës, të së mirës, të së mbarës, të lirisë. Në emër të vërvetes



Intervistoi: Avni HALIMI

Në ciklin e intervistave me personalitete të shquara kombëtare në sferën e kulturës, kësaj radhe do të flasim me një nga poetët më të mirë shqiptar, Visar Zhitin, i cili pati fatin që ta pérjetojë burgun e regjimit komunist për poezitë e tij. Punoi edhe si ministër për kulturë, deputet në parlamentin shqiptar, si dhe diplomat, porse në asnjë nga këto fazat e karierës së vet nuk hoqi dorë nga krijimtaria letrare. Me Visar Zhitin në këtë intervistë do të shtjellojmë një varg problemesh e fenomenesh kulturore mbarëkombëtare:

HEJZA: Në fillim qe Fjala, fjala si mundësi komunikimi! Pastaj liria e krijuar! Erdhi harmonia e përkryer si dhe kriesat për ta kuptuar rëndësinë e baraspeshës së çdo gjëje të krijuar. Popujt, ideologjitet, sistemet që e refuzuan këtë formulë jetësore, përjetuan degradimin, dekadencën, zhdukjen! Le t'i japi këtij definicioni një kuptim estetik! Cili do të ishte ai!

V. ZHITI: Është një pafundësi e parrokshme kohe dhe hapësire, një ecuri gjithë mister, vetë përjetësia,

mendoj, kur duhet të pranojmë se në fillim ishte Fjala. Dhe në fund është Fjala, shtoj unë, kur fund nuk ka ashtu siç nuk ka dhe fillim. Fjala nuk është vetëm mundësi komunikimi, as vetëm mjet i saj. Fjala është histori dhe fryshtë. Madje filozofohet se ishte Fjala dhe më pas u bënë ato që përcakton e shpreh fjala. Është e mrekullueshme teologjia e fjalës. Edhe estetikisht ne jemi ajo që themi, po aq të shëmtuar, por dhe po aq të bukur sa Fjala e thënë me ne.

HEJZA: Ju, si krijues, e keni përjetuar edhe mungesën e lirisë për të krijuar por edhe mungesën e lirisë krijuese. Cila nga këto dy mungesa është më e trishtë për krijuesin?

V. ZHITI: Jemi midis dy lirive, asaj të jashtimes, që është liria që na japid dhe japid, që lejojnë forcat madhore të realitetit, mbijetesa, shteti, etj, por është dhe liria e brendshme, që varet shumë nga ne, më e rëndësishmja. Për rrjedhojë edhe për krijuesin janë liria që ke për të krijuar, totalitarizmi e jep me racione sa do dhe si t'i duhet, dhe është liria krijuese, që varet dhe nga kultura që ke, guximi artistik e fantazia, etj. Mungesa e lirisë për të krijuar është jo vetëm e trishtë, por

dhe torturuese, ndërsa liria krijuese mundohet të gjiej rrugëdaljeje, shpërthime të dukshme dhe te padukshme dhe mbasë një kërkim i tillë shpiku metaforën...

HEJZA: Frymëzimi krijues në burg dhe frymëzimi krijues në parajsë-li-ri! Cili e ka rrjedhën më të furishme?

V. ZHITI: Në burg nuk na lejohej krijimi, ishim sklevër, pra "ishte e ndaluar të frymëzoheshe", kurse liria është plot mundësi dhe, besoj, triumfon ajo të cilën ka më të fortë krijuesi, liria e brendshme apo "liria për të krijuar" siç e thatë aq saktë ju. Vetë furia e frymëzimit është liri...

HEJZA: Pse u burgos Visar Zhitin dhe jo edhe të tjerët! Shkrimtarët e mirëfilltë në esencë janë xhelatë të pushteteve totalitariste! Ishte kjo "lotari e jetës" apo linçoheshin Visar Zhitin për t'u frymëzuar të tjerët me dashuri për "pushtetin absolut"?

V. ZHITI: Në qoftë se do të hapim dosjen e dënimit të Visar Zhitit, aty do të gjejmë se ai është dënuar për poezi, sipas ekspertëve të Realizmit Socialist në diktaturë ato ishin armiqësore, kur vetëm poezia

s'mund të jetë e tillë. Policia sekrete politike përbëhej dhe nga redaktorë të botimeve, anëtarë të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, kështu rezulton. Ata përcaktuan para se të bëhej gjyqi, pra, ishte vendimi i tyre para atij të gjyqit, që jo vetëm poezitë e tij ishin "të trishta, hermetike, kundër sistemit", por dhe ai, Visar Zhitin, ishte armik. Mund të them se Visar Zhitin u dënuar përrugën që zgjodhi vetë, të shkojë në ferr, duke u ndërgjegjësuar gjithnjë e më shumë, duke i humbur dhe shpresat, i papenduar, por kjo nuk do të thotë se ai nuk e kishte kuptuar humbjen dhe humnerën, e vuante tmerrësish keq duke menduar shpesh dhe vetëvrasjen. Dhe po kështu është tejet e rendë, që ka pasur dhe ka të tillë, që janë "frymëzuar" nga këto dënimë, madje kanë qenë zelltarë të tyre dhe kanë ndihmuar me denoncime të fshehta, me dëshmitë gjyqeve, deri edhe letra diktatorit Enver Hoxha, edhe pse shkruan poezi, kështu u dukej, dhe kjo bëhej jo vetëm nga "dashuria për pushtetin dhe për pushtet", por dhe nga zilitë dhe ambiciet vrastare, nga paaftësia për te genë njerëz.... Letërsia e madhe është gjithmonë kundër...

HEJZA: Kur nis disidenca në letërsinë shqiptare! A ka përfunduar ajo dhe, nëse po, a nuk do të duhet të zgjoste përfjetësish, derisa të ekzistojnë pushtetet politike. Vdekja e disidencës përballë pushteteve politike do të thotë disbalancim i përbërësve të së bukurës, të së mirës, të së mbarës, të lirisë...

V. ZHITI: Në konceptin tim letërsia në vetvete ka brenda disidencën, sepse çdo vepër e mirë vjen për të qenë ndryshe nga të tjerat, bën një ndarje, ndërkak qjo ka mospëlqimet e veta me realitetet, me estetikat e tyre, pra, le ta quajmë disidencë estetike. Duke u nisur nga përmbytjet, spikasin disidencat ideologjike, politike, por në letërsi unë quaj më të rëndësishme disidencën në shije. Të dimë të duam dhe të dimë të përcmojmë. Disidenca në letërsinë shqipe, në kuptimin ideor të çeshtjes, nisi me diktatin që u ushtrua ndaj saj, kur u zyrtarizua Realizmi Socialist si e vërmja metodë letrare dhe u bë detyrim për shkrimitarët dhe artistët dhe, sipas konceptit vrastar Lenini, letërsia dhe artet duhet të ishin në shërbim të Partisë në pushtet, ideologjisë dhe politikave të saj, pra propagandë, "vidë dhe burmë" siç e thoshte barbarisht Lenini. Disidenca në letrat shqipe nuk lejohej, prandaj ka nga ata që nuk besojnë apo nuk u duhet ta besojnë se ka pasur disidencë. Meqenëse nuk lejohej, nuk do të thotë se nuk ka qenë. Disidenca në letërsinë shqipe ka qenë e fshehtë, e pa organizuar, vetanake siç është dhe vetë letërsia, guxoi deri në heroizëm dhe u martirizua. Tashmë ajo është një realitet me vepra, një përvojë që i shërbën të sotmes dhe të ardhmes, do të jetë deri sa të ketë pushtete mbi të, në mbrojtje dhe në emër të së bukurës, të së mirës, të së mbarës, të lirisë. Në emër të vvetveteve.

HEJZA: Vuajtja si kategori shpirtërore! Një shkrimitar në burg dhe tjetri në liri! Shkrimitari në burg

ngulfatet nga frysëzimi për të shkruar, por nuk ka ku dhe si të shkruajë! Shkrimitari në liri i ka të gjitha por i mungon frysëzimi për të shkruar! Pozitën e shkrimitarit të parë e keni përfjetuar vetë. Mbësë e keni përfjetuar edhe pozitën e shkrimitarit të dytë! Cila është më e rëndë?

V. ZHITI: Mendoj se janë vuajtje që s'kanë të krahasuar. Kur je në burg dhe të vjen djalli i frysëzimit, por nuk shkruan dot, se nuk lejohet, pra nuk të lënë të bësh shkrimitar, kurse kurje jashtë, i lirë, por nuk shkruan se nuk ke frysëzime, por mungesë të tij, kriza, qoftë dhe e shkrimitarit, nuk është shkrimitar, por patologji tjetër, jashtë letrare, etj, etj. Të moshkuarit nuk është letërsi. E rëndë është, kur nuk të lënë të shkruash...

HEJZA: Si shkrimitar keni pasur rastin të krijoni edhe në mërgim! Motivi i mërgimit në letërsinë shqiptare (sidomos në atë të krijuar në viset etnike shqiptare, jashtë kufijve të shtetit amë) ka qenë një prej motiveve më të shpeshta dhe më të trisha! Sot, në dëshirën e flaktë të shqiptarëve për të migruar në Perëndim, a mund të gjymë arsyet e kuptim në kultivimin e këtij motivi në krijimtarinë e përgjithshme artistike.

V. ZHITI: Mërgimi është një dukuri e hershme, edhe popujt kanë lëvizur duke lenë një gjë dhe duke marrë një tjetër, botë shpirtërore, kulture. Krahas brengës dhe mallit, ato e kanë pasuruar letërsinë me zbulime të tjera, qoftë dhe me subjekte e motive, me qëndrime të reja ndaj botës. Sipas meje çdo motiv mund të trajtohet në një letërsi, edhe mërgimi, ndërsa mërgimi në gjuhë mendoj se kërkon trajtim tjetër, është largimi nga letërsia amë në letërsinë e një populli tjetër.

HEJZA: Arsyet politike për migrim

dhe migrimi si pasojë e zhgënijimit nga politika! Me gjasë, që të dyja i kemi si kamuflim të egos sonë: dëshirë për një jetë më të mirë, më të lumtur! Pa dyshim, kjo dëshirë te popujt e tjerë perceptohet si normale, si shumë njerëzore. Pse kjo "dëshirë moderne" për protagonistë, për heroizëm ndërkohë që e kemi më të lehtë ta përmbysim mekanizmin që e shtynë furishëm migrimin: sistemet politike!

V. ZHITI: Keni të drejtë me arsyetimin tuaj. Shkak ikjesh mund të jetë dhe politika e mbërapshtë, zhgënijimet, të moskenit dakord me praktikat e saj, kur sjellin dëm e ti nuk do të jesh pjesë një politikë të caktuar, dhunuese, etj, etj, por dëshira për një jetë tjetër, ndryshe apo më të mirë apo kërkëria për botën, pa protagonistë apo heroizëm janë shkaqe ikjesh. Çështjet politike edhe ndryshohen me ndryshime të qeverive me zgjedhje të lira apo ngritje krye, etj, po për ndokënd a shumëve të tillë, që duan të ndryshojnë jetën e tyre, duhet të ndryshojnë dhe vendin. Por atdheu mbetet atdhe.

HEJZA: Një popull, një histori, një gjuhë, një kulturë, por, me shumë politika kulturore. E kemi në terezi këtë punë? Çdo periudhë i ka shtresëzimet e veta kulturore dhe, sot, me plotë gojë mund të themi se nga e kaluara janë kemi një trashëgimi të mrekullueshme kulturore, e cila flet për një civilizim të padiskutueshëm të të parëve tanë. Por, çdo të thonë pas njëmijë vitesh pasardhësit tanë për shtresëzimin e sotshëm kulturore. Ç'trashëgimi kulturore po u lëmë pasardhësve tanë?

V. ZHITI: E kam të vështirë, madje të pamundur të parashikoj se ç'do të mund të thonë pas një mijë vjetësh pasardhësit tanë për kulturën sot, që do t'u lëmë. Ç'do të jetë ajo, si dhe çfarë do të mbërrrijë? Mijëvjeçarët e

mëparshëm dhanë një histori dhe na lanë një gjuhë, pasuria më e madhe për popullin tonë dhe kulturën e mbijetesës. Mijëvjeçarët e ardhshëm do të kenë një shpejtësi zhvillimi që nuk e imagjinojmë dot, shpejtësi drite dhe dimensione që s'i dimë... Lutem që mbi truallin tonë të mbeten gjurmë dhe veprat për pasardhësit, t'i shërbjnë njohjes së ecurisë së popullit të tyre, në identitet e kulturë, për një mendje të begatë e shpirt të pavdekshëm...

HEJZA: Për vuajtjet si pasojë e regjimeve totalitariste më lehtë e kemi t'i citojmë poetët rusë, polakë, çekë, bullgarë, se sa poetët shqiptar. E kemi si rrjetohjë e demagogjisë apo, thjesht, nuk njihemi në mes vete, nuk lexohemi! Ç'vuajtje ka mundur të pësojë më shumë një poet rus se sa një Visar Zhiti, apo një Teki Dervishi, q'mendim estetik më të madh do të mund të kishte lënë Haveli se sa Ibrahim Rugova, Rexhep Qosja, Sabri Hamiti, q'poezi më të mirë do të kishte një disident polak se sa Jusuf Gërvalla etj. Ç'nivel intelektual e kulturor do të ishte njohja e kulturave të huaja ndërsa njohuritë mbi kulturën kombëtare i ke copë-copë?

V. ZHITI: Është një pyetje që më ka goditur dhe mua, e çmoj. E kam ndjerë, që tek ne u duket më me rëndësi, madje vuajtje më aventure, burg më spektakolar ai i të huajve, rusë sidomos dhe disidencë më e arsyeshme ajo e një polaku apo çeku, hungarezi, mongoli etj. Mbështë kompleks, një si nënshtirim ndaj çdo gjëje të huaj, prangat jashtë mbështë janë më të bukura, ndërsa qëndresa janë, qoftë në Shqipërinë e copëtuar me mizorë mbi krye dhe në Kosovë me të huajt e pamëshirshëm a në Maqedoninë e Veriut, e Jugut për ne, janë të denja, që nderojnë çdo popull, madhështore. Vargjet e poetëve të pushkatuar dhe vrarë burgjeve, t'i kishte një popull tjetër,



do t'i gdhendte në mermmer dhe nxënësit do t'i mësonin përmendësh nëpër shkolla. Ndonjëherë më duket se ky moskujdes, ky harrim i qëllimtë i vuajtjes, i emrave të atyre që i bënë ballë të keqes edhe për ne, është një koracë vetes, e atyre që nuk guxuan për më shumë, ca më keq, që u bënë dhe pjesë e së keqes dhe për një alibi hipokrite thërrasin të nderojnë heronjtë e popujve te tjerë, që natyrisht e meritojnë. Por bëje këtë dhe me martirizimin e vëllezërve të tu!

HEJZA: Fatkeqësisht, kasta artistike shqiptare nuk njihet në mes vete, nuk respektohet, ndërsa nuk duket në horizont asnjë shenjë, asnjë përpjekje për një platformë të përbashkët kulturore që do të ishte si nismë historike për bashkim kombëtar në rrafshin kulturor.

V. ZHITI: Do t'më vinte shumë keq, nëse do të ishte plotësisht kështu. E kuptoj pakënaqësinë tuaj për gjendjen, ajo është dhe apel intelektual për përmirësim, për të bërë më shumë ndaj asaj që éndërrohet. Mendoj se në botën e artistike shqiptare nijihen me njëri-tjetrin dhe vlerësohen ndërsjellës, por duhet dhe organizim, takime dhe veprimitari të përbashkëta, kuvende e platforma për ardhmërinë. Do të thosha se institucionet shtetërore përgjegjëse për kulturën dhe artet kanë përgjegjësi të madhe dhe detyra bashkëpunimi, për njohjen e vlerave gjithkund ku ka shqiptarë, t'i shpërndajnë dhe përhapin, të punojnë për mundësimë gjithëpërfshirëse në krijimin e vlerave të reja dhe konkretizimin që ju thoni me të drejtë, për një ardhmëri kulturore kombëtare të përbashkët. Duhen jo vetëm për mbijetesë dhe identitet, por dhe përkulturë jetike.

HEJZA: Antologjitet e shpeshta të poezisë shqiptare më shumë shprehin mentalitetin tonë krahinor se sa përgatitjen profesionale për vepra të tillë reprezentative! Botohet "Antologjia e poezisë shqiptare" ndërsa aty nuk përfshihet asnjë poet nga viset e tjera etnik! Për të genë trishtimi edhe më i madh, mblidhen poetë, demagogë e mediokër dhe e promovojnë si kryevepër shqiptare! Këto ndasi të qëllimta do të duhej të dënoheshin si tradhti kombëtare! Akoma nuk kemi një shfaqje teatrale të përbashkët, akoma nuk kemi një film të përbashkët, një koreografi, një koncert me instrumentistë e interpretues të përbashkët, nuk kemi akoma një eksposítë të piktorëve shqiptarë nga të gjitha trevat etnike...

V. ZHITI: Janë çështje me rëndësi dhe me vlerë këto që parashtroni, madje dhe të bukura. Përsa u përket antologjive, me sa kam informacion, janë aq të shumta dhe të shumëllotja, mbi 300 kanë dalë pas viteve '90 dhe nuk mund të kërkojmë nga asnjëra gjithçka. Ato kanë emrat e hartuesve, një autor për autorët që ka përgjedhur, pra, si të thuash nuk është çështje dhe aq e letërsisë, as meritë e atyre që janë të përfshirë në një antologji dhe as pazotësi e atyre që nuk janë përfshirë. Kanë subjektivitet të pashmangshëm, ndonjëherë dhe të keq. Unë mendoj se nuk do të ishte mirë nëse një antologji do të mund ta përfshinte të gjithë letërsinë. Ajo, e mbeatura jashtë një antologjie, sipas meje,



duhet të jete po aq e mirë sa e përfshi-ra, e denjë për një antologji tjetër të një kriteri tjetër. A janë të kritikueshme antologjitet? Patjetër që po, edhe kur subjektiviteti nuk është aq flagrant. Por kur kriteret e hartimin të saj janë jashtëletare, sidomos ideo-politike apo kur ndokush është gati të kacafytet fizikisht se mungojnë poetët e lokalitetit të tij, duke pasur parasysh veten, i përmend me emër të munguarit që t'i nxisë në një rebelim socrealist, ky është një grotesk mëritës. Dënim i saktë është të mos merremi me to. Unë di që ka antologji të mira e shumë të mira, edhe pse mund të janë të pakta, për to duhet të diskutohet më shumë. Dhe kur ato dalin në një vend tjetër e gjuhë tjetër, fakti që botohen, gjuhë tjetër dhe vendi tjetër ka parë vlera, mirénjohës haruesit apo hartuesve të tyre dhe përkthyesit. Gjithsesi janë një pasqyrë e letrave tona deri në atë ditë, ta pranojmë arritjen, t'i gëzohem i estetikisht me dëshirën dhe kritikën që herë tjetër pasqyra të ndrisë më bukur. Ideja juaj, ai propozim për shfaqje teatrore mbarëkombëtare, me artistë brenda dhe jashtë kufijve zyrtarë, politikë, të

cilët kanë ndarë trojet tona, që assesi nuk duhet të bien më mbi kulturën tonë e ndërgjegjet tona, pra, për filma të përbashkët, koncerete, balet, ekspozita, etj, është dobiprurëse dhe progresive. Janë të munduara, duan prirës, bashkëpunëtorë, mbështetës. Dashuri për artin e popullit tënd, përvetë popullin.

HEJZA: Pa themelimin e institucioneve kombëtare kulturore, që shtrihen përtëj kufijve shtetëror ("ansambla shtetëror", "teatri shtetëror", "opera shtetërore") nuk mund të themi se po vërehen shenja të një bashkimi kombëtar në rrafshin kulturor. Akoma një biznesmen i Kosovës nuk ka sponsorizuar një shfaqje apo një libër të një krijuesi nga Gjirokastra, Durrësi, Fieri, Berati, apo, një biznesmen nga Berati ta sponsorizonte një vepër artistike nga Ferizaj, Shkupi, Ulqini, Preshevë... Kurse, shih paradoksin, një hoxhë, me rastin e pensionimit të tij, nga popullata shpërblehet me një Mercedes të fjälës së fundit, që do të kushtonte sa buxheti vjetor i Teatrit të Prishtinës apo Tiranës! Ç'po ndodhë me ne? Sikur më shumë po



japim shenja të vullnetit për akulturim se sa për ngritje kulturore institucionale!

V. ZHITI: Bashkohem me shqetësimin tuaj, pa dashur të bëj krahasime e paralele, njerëzit janë të lirë të zgjedhin. Mendoj se me përpjekje më shumë e më me largpamësi mund dhe duhet të kemi ndërveprime të përbashkëta kulturore dhe siç e thoni dhe ju, "ansamblin" më shumë se sa "shtetëror" do ta dëshiroja kombëtar, as teatër shtetëror, por kombëtar, as opera shtetërore, të mos këndojnë ministrat me kryeministrin, por të punojnë, pra opera kombëtare, veç shteti të ishte sa më shtetëror dhe sa më pak privat e vetanak.

HEJZA: Aktualisht Visar Zhiti jeton në SHBA! Pa dyshim, ju mund ta dëgjoni zërin e vendlindjes, të atdheut, që ju fton e që ju çon peshë! Ju keni thënë se shkrimitari krijon ashtu siç jeton! Nën presionin e zërit kumbues të vendlindjes dhe mënyrës së jetesës së re, e ndani akoma të njëjtin mendim!

V. ZHITI: Unë vërtet këto vitet e fundi po jetoj larg dheut amë, e kam thënë, pasi i kreva të gjitha detyrat ndaj shtetit në vendin tim, shpërngula shtëpinë, por jo gjuhën si shkrimitar, as shqetësimet, as dhimbjet dhe gjëzimet e përbashkëta, vazhdoj ta thur po njëlloj elegjinë time, ndoshta po e pasuroj, SHBA është botë e madhe, pra, nuk ndjehem i ikur. Na duhej paqe më shumë e qetësi më shumë, një vetëmbrojtje nga ajo që na godet, nga rruga, një tjetër mirëkuptim me jetën, etj, dhe desha t'i largohesha rutinës së një hipokrizie gjenerale, sa zyrtare po aq dhe miqësore, nëse mund të quhet hipokrizia miqësore, megjithëse tek ne ekziston dhe ajo hipokrizi që nuk gjendet kurrikund, besoj, tjetri mashtron me vetëdije hipokrite, të shan me hipokrizi sepse do apo i duhet, pra hipokrizi dhe në të keq, duke cenuar rëndë moralin e vetes. Jo se shpëtova tërësisht dhe këtej larg. Pas rënies së perandorisë komuniste kanë mbërritur më parë ata që ishin me persekuitorët se sa vetë të persekuitorët. Kjo më bind që jam ende në fushën e betejës. Pa merak, ndaj të njëjtin mendim, sepse dhe nuk me është ndarë...

HEJZA: Ç'po shkruani për momentin? A po shkruani siç po jetoni, apo, megjithatë, keni akoma përtë shkruar për jetën që e jetuat si mos më keq, burgjeve të totalitarizmit shqiptar!

V. ZHITI: Nuk po shkruaj gjë për momentin, në kuptimin se nuk kam gjë të castit, përvëc atyre që hedh në fb. Letërsinë e shoh si përkushtim ndaj të gjithmonës, edhe pse mund ta nxjerrë momenti, pavarësisht se sa ia del. Realitetin e shoh si të pashtershëm. Në burgjet e totalitarizmit shqiptar kishte vuajtje të madhe, tmerr dhe mbyllje, frikë dhe qëndresë, absurd dhe zi, çmenduri, vegime dhe revoltë, nga ato që futen në histori, por çuditërisht dhe poezi brenda telave me gjemba, dinjitet të copërluar njerëzor, ndërsa jeta si mos më keq më shumë bëhej jashtë burgut, me urrejtje dhe shtirje, mërzi, dyzim të personalitetit, as maskat nuk ishin të bukura, me baltën e së keqes... do të doja që e gjitha kjo, të mund të shkruhet...

ARTI DHE PËRVOJA FETARE

Largimi i përvojës dhe emocionit fetar nga rregullat parimore fetare e dëmton orientimin fetar, ndërsa largimi i muzikës nga origjina e saj, që është ushqim i shpirtit dhe (keq)përdorimi i saj për çështje të ulëta e humb vlerën e saj jo vetëm nga aspekti fetar, por edhe nga aspekti artistik dhe estetik



Nga Metin IZETI

E shenja është shfaqur në mënyra të ndryshme në periudha të ndryshme. Mënyra më e zakonshme e shfaqjes së të shenjtës është përmasa artistike. Biseda përmarrëdhënien e së shenjtës me një degë të caktuar të artit është e vjetër aq sa edhe vetë njeriu, pastaj kjo bisedë është zgjatur në marrëdhënien e të shenjtës me të gjitha degët e artit. Sepse të gjitha degët e artit janë të ngjashme me njëra-tjetrën, të lidhura me njëra-tjetrën dhe plotësojnë njëra-tjetrën.

Arti dhe feja janë të ndërthurura që nga kohërat e lashta. Njerëzit besimtarë kryejnë adhurime dhe rituale përtë qenë në kontakt me forcën transcedente, të cilën ata e pranojnë se ekziston dhe luten përtë krijuar një lidhje me Krijuesin. Në këtë kontekst arti, ose më konkretisht muzika dhe melodia shfaqen gjithashtu si elementë të domosdoshëm të këtyre adhurimeve. Shpeshherë adhurimi kryhet në mënyrë ritmike dhe melodike, edhe nga njerëz që nuk e njohin muzikën. Në çdo traditë fetare muzika e ka vendin e vet të veçantë. Njeriu mund të emocionohet me besimin e tij nëpërmjet melodisë së duhur, me një efekt më të fortë se pa të. Kjo melodi e drejtë gjithashtu mund t'i afrojë njerëzit me Zotin.

Përvoja fetare, si element besimi, ka shërbyer si urë lidhëse mes besimtarëve dhe Zotit. Duke marrë parasysh se estetika dhe përvoja fetare janë në të njëjtin terren, nuk do të ishte gabim të thuhet se ekziston një marrëdhënie e ngushtë midis përvojës fetare dhe artit. Mënyra më adekuate përtë përfjetuar të shenjtën është përmes artit. Arti, nëpërmjet vizionit emocional, ka fuqinë t'ua shpjegojë Zotin njerëzve, t'ua bëjë më të lehtë ta kuptojnë Atë dëtë t'i bëjë ata ta përfjetojnë Atë.

Për sa kohë që një person është në botën materiale, ai shpesh ka

vështirësi në të kupuarit e asaj që i përket botës metafizike. Përtë këtë arsy, elementët e jashtëm ndonjëherë janë të nevojshëm përtë i kujtuar njerëzit dhe përtë i bërë atë të ndiejnë Zotin. Sepse Zoti mund të kapet me zemër dhe jo me mendje. Nëse një person nuk është i vetëdijshëm përtë emocionet e tij dhe nuk mund të ndiejë ekzistencën e shpirtit të tij, ai nuk do të jetë në gjendje ta kuptojë Zotin. Kjo është arsyja pse arti luan një rol aktiv në këtë pikë. Zoti është i brendshëm, por nëpërmjet një vepre artistike ai mund të fitojë një kuptim në shpirtin e njeriut dhe të bëhet më i kaphshëm përtë njerëzit.

Detyra e një besimtarë është të kërkojë Zotin dhe ta gjejë Atë në botën ku është dërguar si sprovë. Kjo nuk është aq e lehtë sa duket. Mënyra përtë gjetur Zotin është të ndjekësh gjurmët hyjnore. Sipas shumë urtarëve, mënyra më themelore përtë t'u lidhur me Zotin është arti. Muzika është një nga artet që i përshtatet më së miri natyrës njerëzore. Përtë këtë arsy, njerëzit kanë një ndjenjë besimi në muzikë. Duke marrë parasysh që Zoti është edhe brenda njerëzve, nuk është e çuditshme që muzika të ketë aftësinë të zbulojë Krijuesin e Lartë dhe ta bëjë njeriun që ta përfjetojë Atë. Sepse muzika, me fuqinë e saj të ndikimit, mund ta edukojë shpirtin njerëzor, ta afrojë atë me Zotin, t'i mundësojë të kuptojë urdhrat e Tij dhe të bëhet i zbutur ndaj Tij. Muzika mund të shfaqet si një element efektiv dhe rezultat në përvojën fetare. Këtë e mbështesin edhe deklaratat e atyre që kanë pasur përvoja të larta fetare.

Përvoja fetare është ndjesia e Zotit, dhe ndonjëherë është marrja e informacionit nga Ai nëpërmjet fryshtimit dhe arritja e njohjes përtë Të. Në këtë pikë, muzika vepron si një mjet, duke e bërë më të lehtë përtë njerëzit të ndjejnë Zotin. Elementet e vetëdijes estetike dhe besimit janë të qenësishme tek njerëzit dhe kom-

binohen përtë krijuar një drejtim të përbashkët. Në këtë drejtim, është vërejtur se besimi dhe muzika shpesh përdoren së bashku. Kur elementet e besimit përdoren në fusha të ndryshme të artit, efektet pozitive shihen te njerëzit me vetëdije estetike. Prandaj, lirisht mund të thuhet se feja ushqen artin dhe arti ushqen fenë.

Arti shpesh shfaqet si një mjet për pastrimin e zemrës. Sepse përvoja shpirtnore e bën njeriun të vetëdijshëm përtë gabimet që ka bërë ndaj Zotit. Aty ku ndihet prania e Zotit, gjérat e tjera nuk kanëasnë kuptim. Arti në përgjithësi ndikon në këndvështrimin e njerëzve përtjetën në një mënyrë pozitive dhe kjo e përforcon edhe besimin dhe ndikon në arritjen e përfjetimeve fetare dhe në ndërtimin e përvojës fetare pozitive.

Kur bëhet fjalë përtë ekstazën përmes muzikës, padyshim një nga emrat e parë që vjen ndërmend është Mevlana Xhelaluddin Rumiu. Ka shumë vargje të shkruara përtë raportin e tij me muzikën, të cilat gjejnë vend jo vetëm në kulturën islamë, por edhe në atë perëndimore. Është një fenomen i zakonshëm që muzika u kujton njerëzve Zotin dhe i bën ata të harrojnë botën, herë me një emocion shumë të fuqishëm e herë të menjëherëshëm. Si në çdo gjë tjetër, edhe këtu ka një rëndësi të madhe mënyra se si përcaktohet përvoja. Përvoja fetare dhe arti, ose më drejtë, në këtë rast muzika relacionin e tyre e ndërtojnë në bazë të rregullave që i kanë të dyja fushat. Largimi i përvojës dhe emocionit fetar nga rregullat parimore fetare e dëmton orientimin fetar, ndërsa largimi i muzikës nga origjina e saj, që është ushqim i shpirtit dhe (keq)përdorimi i saj përtë çështje të ulëta e humb vlerën e saj jo vetëm nga aspekti fetar, por edhe nga aspekti artistik dhe estetik.

Duhet të kemi parasysh gjithashtu se mendimtarë të rëndësishëm

islamë si Ibn Sina, Farabi dhe Kindi kanë shkruar vepra në fushën e muzikës. Mendimtarët e përmendur zhvilluan teori muzikore që janë të vlefshme edhe sot. Për shembull, Farabi, një nga këta mendimtarë, e diskutoi muzikën si fushë të shkencës në çdo aspekt në veprat e tij mbi muzikën, në një mënyrë që kurrë nuk është diskutuar aq hollësishët në asnjë burim para tij. Tema të tilla si formimi i tingullit, objektet që prodhojnë dhe nuk prodhojnë tingull, arsyet e lartësisë dhe ashpërsisë së tingullit, formimi i melodive, intervali midis dy melodive...

Përtë këtë ai ka dhënë edhe mendime të shumta. Sipas tij, muzika është thelbësore jo vetëm përtë njerëzit, por përtë gjitha gjallesat. Ai thotë se tingujt lindin instinktivisht, veçanërisht te kafshët dhe se ata nxjerrin tinguj të ndryshëm në gjendje të ndryshme emocionale. Sipas Farabiut, nëse muzika e duhur dëgjohet në kohën e duhur, arrihet në edukim esencial shpirtëror. Modet ndikojnë në shpirtin e njeriut në mënyra të ndryshme. Disa melodi krijojnë një ndjenjë lumturie dhe relaksim njerëzit.


Ebu Sulejman Darani, një nga sufite e njohur klasik ka thënë: "Një zë i bukur nuk sjell në zemër diçka që nuk ka qenë më parë në zemër." Që do të thotë se nëse ndonjë prej arteve, më konkretisht muzika ndikon në përkëqësimin e personalitetit të njeriut, atëherë nevojitet pastrimi i zemrës dhe jo ndalimi i artit.

Instinkti përtë besuar, ashtu si muzika, ka ekzistuar në jetën e njerëzve që në ditët e para të historisë njerëzore dhe ka luajtur një rol në formësimin e jetës së tyre. Ky fenomen mori një formë adekuat kur Zoti ndërhyri duke dërguar pejgamberët në botë. Që nga kjo fazë e në vazhdim melodia është shfaqur si një fenomen normativ që synon të rregullojë jetën e besimtarëve.

Gjatë historisë ka pasur disa debate në lidhje me legjitimitetin fetar të muzikës. Ideja se muzika është e ndaluar nga feja, e cila vazhdon ende sot, mund të ndikojë negativisht në pikëpamjen përtë muzikën, por amë ajo është e pranishme në të gjitha periudhat dhe në formë ndryshme edhe në mjediset e besimtarëve. Megjithatë, muzika prek njerëzit me përbajtjen, me ndjenjën e ritmit që njerëzit e ndiejnë natyrshëm me zemër dhe ndonjëherë, kur merren parasysh thëniet e besimtarëve të singertë, rrit besimin e individuve dhe krijon përvoja fetare. Ndjenja e besimit dhe muzika tërheq shpirtin e njeriut. Këto dy dukuri dhe ndërveprimi ndërmjet tyre, kur drejtohen drejt, kontribuojnë në zhvillimin e përvojës fetare dhe besimit të individit.

ANTON PASHKU

Pashku nuk shkruar shumë, por ka bërë art të kulluar letrar dhe vepra e tij është një krua ku lexuesit mund të shuajnë etjen



Ndue UKAJ

Anton Pashku ka krijuar një letërsi madhështore dhe njohja e rinjohja me të, na hapin shtigje kah e bukura dhe estetika. Antoni është shkrimitar klasik dhe i klasit të lartë, vepra e tij e cilit është një monument madhështor kulturor dhe

duhet të shërbejë si busulle kulturore e letrare.

Autor i romanit "Oh" dhe i librave me tregime, drama, Pashku mbetet njëri nga zërat më origjinal dhe më autentik të letërsisë shqipe, sidomos asaj të krijuar në Kosovë. Proza e tij e shkruar në kushte të egra ideologjike, para lexuesit

shfaqet e pasur dhe krejt imune ndaj deduksioneve të shkreta të kohës, që e varfëronin letërsinë. Kështu, letërsia e tij paraqet një botë të pasur tematike e gjuhësore, ku autentikja e universalja bashkëjetojnë si në simfoni të përkryer. Pashku nuk shkruar shumë, por ka bërë art të kulluar letrar dhe vepra

e tij është një krua ku lexuesit mund të shuajnë etjen.

Stilist dhe rrëfimtar i madh, ai në prozë di të krijojë situata magjike narrative, që lexuesin e endin në një botë të pafundme imagjinare, të bukurisë së gjuhës dhe të shkrimit, të situatës dhe të veprimit. Pashku është vlerësuar prozator moderne, veprën e së cilit e karakterizon një ligjërim madhështor, me një gjuhë mikluese dhe të ëmbël estetike, ku bashkëjetojnë ndjeshmëritë letrare dhe kulta letrare. Pashku tregon dashuri të pafund për tekstin, përfjalën, tingullin, fjalinë, imazhin, situatën. Ai çdo situatë narrative e përshkruan me finesa estetike mahnitëse, me detaje dhe brenda rrëfimit, hyjnë e dalin personazhe që enden në vorbullën e jetës dhe përjetojnë vrushkujt e saj, ose, dehën nën magjinë e parfumit të natyrës.

Prandaj, ta kujtojmë Antonin, sepse me vepra të mira, siç është vepra e tij, mund t' i aktivizojmë antirrupat ndaj shëmtisë dhe kundër baktereve të shumta që vërtiten ndër ne. Po, këto bakteri asgjë s'i lufton më mirë se arti i mirë dhe fisnik, prandaj, në këtë kohë të vështirë, më mirë është t'i ngrohim zemrat me gjuhën e pasur të letërsisë, sesa të mbytemi në cektësi mendimesh të ashtuquajtura politike.

Pikëpamje

LETËRSIA E SIRTARIT

"Letërsia e sirtarit" ekzistonte dhe disa nga autorët dëshmuant të janë të jashtëzakonshëm si në të gjithë Europën Lindore, edhe në Shqipëri



Luan TOPÇIU

Si në çdo vend tjetër të Lindjes së Europës, pas rrëzimit të komunizmit në Shqipëri pati një pritshmëri dhe një kërshtëri të shihej se çfarë ishte "letërsia e sirtarit", siç është bërë zakon të quhet letërsia e ndaluar, e censuruar, e pabotuar dhe letërsia e burgjeve, megjithëse në

Shqipëri kjo lloj letërsie dukej e pamundur, për shkak të diktaturës më të egër dhe të burgjeve më mizore. Pas shumë dëshmive, dorëshkrimeve, veprave të papërfunduara, memuaristikë, të shkruara nga ata autorë që vuajtin burgjeve, – në këtë atelie të ferrit njerëzor, – dolën në drithë poezi, tregime, romane, drama, letërsi që do t'i nënshtrohej kriterit estetik, ballafaqimt dhe konkurrencës me letërsinë e botuar. Autorët ishin të paktë, të njohur dikur e të ndaluar më vonë, vepra të ndaluara, autorë të ndaluar, autorë që nuk ishin aspak të njohur për publikun, sepse nuk ishin pasur kurrë mundësinë të botonin.

Shqiptarët nuk kanë letërsi sirtari! Kjo gjë dëgjohej menjëherë pas vitit 1990, thirrja triumfale e disa shkrimitarëve të shqetësuar nga reagimet kundër komunizmit dhe diktaturës. Preferonin të thuhej që elitat kulturore janë të kompromentuara tërësisht dhe përfundimisht në vendin tonë. Miti i mungesës së librave të "sirtarit" ishte miti që promovonin ata që ishin rënë në ujdi me Regjimin Komunist, mendonin dhe

shkruanin siç donte regjimi dhe që nuk kishin pasur guximin të ishin ndryshe, goftë dhe për sirtarin e tyre. Këta autorë, jo të paktë, ishin jashtëzakonisht të

motivuar për të përhapur këtë mit që i lante nga mëkatet, domethënë që askush nuk kishte mundur të shkruante fshehuarazi letërsi, për posojë Shqipëria nuk ka pasur elita antikomuniste dhe letërsia shqipe ishte ajo që ishte botuar deri më atëherë. Kështu, përmes këtij miti, duhet të ndodhët një nivelim në rënie, që do të thoshte se nuk kishte pritshmëri për autorë të rinx e të panjohur që mund të kërkonin rishikimin e hierarkisë letrare të deriatëhershme dhe as libra të rinx për t'u zbuluar. Renditja duhej të mbetej e njëjtë, box-office-i identik. Shumë prej tyre kanë luftuar gjatë 30 viteve të fundit për të forcuar këtë klishe për arsyen qarta.

"Letërsia e sirtarit" ekzistonte dhe disa nga autorët dëshmuant të janë të jashtëzakonshëm si në të gjithë Europën Lindore, edhe në Shqipëri. Në veprat që ishin shkruar fshehur nën ciklopizmin e Sigurimit dhe Censurës, ka më shumë të

vërtetë sesa në gjithçka që u shfaq në botimet shtetërore midis 1945-1990. Letërsia ishte e shtetit, e Partisë sunduese.

Kjo situatë gjeneroi pas rënies së sistemit komunist letërsinë e të ashtuquajturve "shkrimitarë të guximshëm" – të cilët denoncan regjimin komunist shumë vjet pasi ai u shemb. Shumë syresh e denoncan komunizmin disa dekada pas zhdukjes së tij. Ata marrin çmimë letrare dhe vlerësimë morale për vlera që nuk i kanë pasur kurrë.

Të ashtuquajturit autorë "trima pas lufte", shkrimitarë oportunistë, janë një bllof dhe mashtrim. Guxim është kur shkruan kundër regjimit, kur e di se je i përndjekur. Guxim është kur botuesit refuzojnë dorëshkrimet e tua përsye politike, kur librat e tu ndalojen dhe je i përgjuar. Guxim është të vazhdosh të shkruash edhe pse je i ndaluar nga Censura. Ata që rishkruajnë biografitë e tyre letrare pas rënies së komunizmit dë krijojnë mite të rreme janë raste të trishta morale, etike dhe njerëzore.

MUSINE KOKALARI: GRUAJA

Me ligjërimin e veçantë dhe konceptin origjinal të vënies së rrëfimit në shtratin real të gruas, vepra e Musines dëshmon fuqinë e reagimit ndaj përdhunimit shpirtëror e psikik të qenies grua

Blerina Rogova GAXHA

Historia letrare na kujton pozitën e derivonshme të gruas në letërsi - një inspiruese, rrallë edhe krijuese. Kohërat kanë ndryshuar dhe zëri i gruas është shndërruar në zë që dëgjohet - zëra të dëshirave, ëndrrave dhe ideve. Një nga këta zëra është edhe ai i Musine Kokalari, gruas që hyri plot pasion në letërsinë shqipe, asaj që i ra hise të kalojë nëpër purgator e të banojë në ferrin e ideologjisë komuniste, e kthyer 100 vjet më vonë, e nderuar si gruaja e veçantë e historisë së letrave shqipe. Sot flasim për autoren që shkroi në moshë të re, por nuk iu përshtat njeriut dhe jetës së re, meqë ishte "e jetët" për hartën e re të kulturës shqiptare, e 'ndotur' politikisht në kohën kur nuk kish jetë politike; shkrimitaren dhe intelektualen e etiketuar 'me njollë' e cila eci shkurt nëpër aventurën e shkrimit duke u imponuar të njohë trajtën më të egër të jetës nën diktaturë, provuar pelimin e harresës, arratisjen nga bota duke qenë brenda saj, e lënë gjallë duke u vrarë.

Kam vënë në titull të këtij leximi emrin 'gruaja' si kujtim për jetën e vrarë pandreqshëm të gruas dhe autores që shkroi për jetën e vrarë të gruas shqiptare. Një kujtim ndaj gruas që luftoi fort për lirinë individuale dhe ishte kjo luftë që ia mori më pas tagrin mbi jetën. I kam vënë emrin Gruaja- duke iu referuar subjektit grua si qenie njerëzore e jo si seks femëror; gruaja - duke e parë atë ekuivalente me autorët që janë burra. Ndaj, edhe në këtë kujtim për të dua të flas për botën në të cilën ajo ka rrnuar, dëshiruar e shkruar në letra- për botën e gruas.

Gruaja

Në tre titujt e biografisë letrare të Musine Kokalarit, dy nga këta, Siç më thotë nënya plakë (1939) dhe Sa u tuntjeta (1944) vënë në qendër gruan, duke e ndjekur kështu fillin e rrugës së letrave që e kërkon universin e gruas. Duke e bërë objekt botën e saj, meqë Subjekti/autorja është vetë grua, loja e jetës luhet në këtë univers, me theksin e vënë mbi njerëzoren, dhe mbi vetë atë. Nisur e ecur në këtë udhë, letërsia e saj bëhet thirrje e qenies së gruas për gruan, por thirrje nga brenda për kuptime përtet kufijve normativ. Emri Musine na jep emrin e shkrimitare e cila brenda natyrës së vet e afiron letërsinë për gruan, tek jep shenja të fortë të kësaj poetike, duke e bërë këtë shenjë identitet të letrave të saj.

Ato - Protagonistet gra flasin në këtë prozë, ato janë zérat që rrëfejnë dhe kërkojnë veshë që i dëgjojnë. Ato janë zérat e humbur nëpër kohë, zérat e historive të humbura që kthehen të kumtøjnë. Zëra që shkëpusin fragmente nga jeta, duke shkëputur kështu një copë historie nga historia e një qytetërimi. Po qysh duken këto karaktere e ç'fityra kanë?

Gruaja e fortë, rebele, ambicioze, ajo e cila ngritët kundër normave dhe mbroni veten, gratë që dinë se çka duan-, jo, të tillë nuk ka te Kokalari. Të gjitha janë të nënshtruar forcës së të tjerrëve. Ato nuk janë heroina të jetës së tyre - por viktima të saj. Personazhet e Kokalarit janë pjesë e një shoqërie patriarkale, asaj shoqërie në të cilën filozofja dhe feministja Simone de Beauvoir e gjien gruan të perceptuar si "tjetri", e dyta pas mashkullit, që konsiderohet e trajtohet si "i pari", kategorizuar në "gjininë e përkryer" dhe "gjininë inferiore" (The Second sex, 1949). Pa dashur të hyjmë terrenit të feministëve, por lidhur me konceptin e gruas



dhe pozitës që ajo zë në këtë tekstrat, ekzistenca e së cilës është e varur nga seksi i parë, mashkulli, që përherë ruan primitin. E gjithë vepra e Kokalarit i referohet një ambienti - Gjirokastrës. Duke qenë protagonistë të dala nga një ambient konkret, si pjesë e tërësisë së sociunitatit patriarchal shqiptar, gruaja e Musines jep ngjyrat e gruas së kohës dhe përtet. Heroinave të tregimeve, u mësohet se çfarë duhet të janë në jetë; çfarë role guxojnë ose nuk guxojnë t'i kenë. Duke qenë e shkelur, protagonistja, është njeriu që e mëson që herët historinë personale "ashtu siç ia kanë shkruar", e mbi këtë mësim duhet të plotësojë plan-programrin. Një jetë që nis e sos sipas një planit. E lidhur fort për traditën, pa guxuar ta éndérrojë ikjen, gruaja e Musines është e myllur, e vrarë, mos me thanë, e vdekur e gjallë. Por kjo nuk e pengon autoren që të krijojë një letërsi në të cilën gruaja është në qendër - edhe kur vuan, edhe kur vajton, edhe kur ankon. Rrëfimi kap situatat e gjendjet e protagonistëve - konfiguracion që di të marrë përmasa dramatike. Përplasja ndërmjet brezave apo statuseve sociale të gruas çon në zhvillime të dramave, të cilat nuk e kërkojnë efektin e tragjikes, por dalin si pamje e jetës duke prekur fundamentalisht reportet e ndërmjetëmve të protagonistëve. Plakat, nënët, gjyshet, mbesat, nuset, vjehrrat, kunatata e fqinjtë; breza të jetë, breza të rinj; gruaja që grindet e luftojnë, dhe gruaja gardiane të 'faqes së bardhë' ushqehen në këtë përditshmëri, ku ushqehen edhe figurat që firmojnë kontratat legale si fejesa e martesa.

Duke e bërë gruan referencë fundamentele të prozës së saj, autorja na kumton se nuk mund t'i rrijë indiferente jetës nëpër të cilën ka kaluar femra shqiptare, presionit mbi të, qenien e shtypur e të

traumatizuar, qenien që i vret dëshirat e veta, e përulur karshi sistemit të normave etike e morale. Nuk mund t'i rrijë indiferente fatit të saj, që gjithnjë mbajti veshur rolet sociale, pa guxuar kurrë të zhvishet e të jetë vetëm vetja. Një grua individuale është e pamjaftueshme dhe e papranueshme si e tillë. Në këto koordinata autorja vë relacionin mes individit dhe shoqërisë, duke e hedhur shikimin nga realiteti social në Shqipëri. Dimensioni social prek prozën e saj, dhe është ky brumë që e motivon. E familjarizuar me mendësinë shqiptare e njohur pushtetin e saj, me shkathtësi ia zbulon ftyrën, tek e krijon dhe rikrijon brenda faqeve. Me femrën e ndodhur në kufijtë e moralit dhe ekzistencës, autorja e letrarizon këtë univers me shkëputjen e copëzave jete ngajeta e bashkësise; copëzat bëhen pjesë e lojës letrare qoftë si kujtesë personale, si kujtesë publike, qoftë si kujtesë nga një kohë tjetër, duke e shndërruar jetën e tyre në kujtesë artistike. Kësosoj, Kokalari lojën në letërsi e bën me fenomene që e përfaqësojnë jetën, pa e shkruar historinë e një gruaje të vëtreme, po nën ombrellën e kryetemës, skema e ndërtuar ruan ndjeshmérinë përtë shkuarën, përtë atëhershëm dhe përtet kësaj kohë, fokusuar në qenien e Asaj/Atyre, si atmosferë permanente e prozës. Socialiteti që përshkon prozën e Musines, e bën autoren një rebele, rebele që nuk afishon por si zonjë butë thérret në emër të jetës dhe shpirtit të lirë. Një rebele që thérret për gruan e vetëm-jafthueshme.

Bota psikologjike - E angazhuar në trajtimin e temës sociale, e fokusuar në shtrimin e rrëfimit në një ambient, Kokalari ngacmohet të gërmojë më thellë, kureshtare të njohë psikën e qenies që e bën objekt letrar. Nëse identiteti i gruas si

gjini femërore formohet socialist, cila është intima e saj, si mendje e emocion? Ndërtimi i karaktereve në tregime dhe roman rrjedh edhe mbi shtratin e botës psikologjike. Kokalari protagonistë i zë kalimthi edhe aty në dhomën e fshehtë të mendjes. Aty ku e zë vetëm. Aty ku gruaja hedh e mbjell farat e dëshirave e të imajjinatës. E interesuar në temën sociale, autorja eksploroni në ato rrethana përtë zbuluar psikologjinë e saj, përti esencializuar karakteret, e rrnuar qoftë edhe për pak në botën që fsheh.

Në këtë botë psikologjike, vështron dhe zbulon proza e Musines, përtë gjetur gruan në burgun e saj si fat, mentalitet e realitet, në provën e fuqishme kundër jetës së munguar dhe zhveshjes së qenies nga vlerat individuale. Me ligjërimin e veçantë dhe konceptin origjinal të vënies së rrëfimit në shtratin real të gruas, vepra e Musines dëshmon fuqinë e reagimit ndaj përdhunimit shpirtëror e psikik të qenies grua. Një poetikë e letrave që buron e sos në "seksin e dytë". Po t'i referohemi idesë së ekzistencialistëve përlirinë individuale, i bie që këto protagonistë rrojnë në atë që quhet "fat i keq", nën ombrellën e të cilit qenjet lejojnë të drejtohen nga identiteti të jashtme. Kësosoj, fakti i të çuarit të jetës pa fuqinë e vendimmarjes nuk reprezenton veten e tyre reale. Në të kundërtën e kësaj vetrave, përfaqësojnë veten e imponuar. Prandaj, kërkimi i "lirisë radikale" sipas leksikut të kësaj filozofie, është i paimagiñueshëm për gruan e Musines. Kjo grua, pjesë e një konteksti dhe një kulturë, e detyruar të luajë rolet e përcaktuara nga të tjerët, e ka të vrasë sensin e lirisë dhe autenticitetin.

Para e mbi gjithçka, ajo duhet të mësojë "qysh me rrnue me faqe të bardhë". Fjalë kjo e cila akoma zë primatin e këshillave prindërore në edukimin e vajzave shqiptare. Kjo është ideja themelore e Kokalarit në tekstet për gruan, dhe kërkosat e saj si kërkesa idesh, pretendojnë ikjen nga normat, konvencat, ikjen drejt lirisë individuale. Në komentin autorit Duke mbaruar, vënë pasthënie e prozës Sa u tuntjeta, lidh kohën e vet me kohën e rrëfimit, duke lansuar idenë e një lidhje tjetër të gruas me botën, një marrëdhënie e re në një kohë të re, me të drejtën e lirisë si autonomi: "Gruaja sot, nga bota e perënduar e djeshme zuri udhën e saj dhe kërkon të jetë përgjegjëse për vehten e saj dhe të marrë pjesë në të gjitha ngjarjet e kohës, kërkon të dijë se ku rròn e përsë rròn në jetë përtë drejtën që ka, si pjesë e pandarë e saj që është", shkruan Kokalari.

Analizë ontologjike e ekzistencës njerëzore - A ishte i saj fat i mirë që ajo iku rrugës së kërkimit të lirisë individuale, apo fati i keq që Musine Kokalari duke qenë pjesë e një kulturë të caktuar, e një kohe dhe konteksti historik thithi shumë nga liria absolute pa e matë edhe peshën e kësaj lirie. Në këtë fat të keq, ajo u ndodh përkshri i ideologjisë dhe armës politike që e goditi fort. Dhe po kaq fort ia goditi lirinë.

Musineja jetoi, provoi e shkroi shkurt në letërsi; shkroi duke njohur së brendshmi natyrën e vet si grua, me intencën e ballafaqimit të kësaj qenjeje, njohjen, banimin me të dhe luftën e përbashkët në botën e vështirë. Një zë gruaje si esencë e qenies së saj, rebelues në jetë e në letra.

P.S.

Poshtëshënimet për shkaqe teknike janë mënjanuar

TOSKËRISHHTJA SI KËNGË E SI MUNDËSI LIRIE

Botimi integral i "Fjalor dialektikor", përvèç risive që sjell në fjalë, ofron edhe një visar shumë të çmuar etnolinguistik

Ledi Shamku SHKRELI

Ky fjalor i toskërishtes të jep mundësi me kuptu se ka shumë e shumë jetë përtej varietet standard, pra shumë shtigje lirie për me ia ushqy shqipes së përbashkët fuqinë e saj shprehëse.

Ky fjalor është njëmend një nga dashnitë e mia. E kam përgatitur vetë dikur për botim, nisur nga dorëshkrimi i mbetur i Pano Tases, dorëshkrim të cilin institucionet e gjuhës nuk ia patën botuar kurrë ngaqë e gjykonin - dhe po i citoj recensat - "pa të drejta qytetarie". Pano Tase vdiq në vitin 1971 dhe mori me vete këtë peng.

Sakaq një e treta e këtij fjalori të sotëm, qe botuar në vitin 1941 në "Visaret e Kombit" nën kujdesin e Sotir Koleas, i cili zgjodhi me botu Gazullin dhe Tasen (gjegë e toskë) përtë pasur kësisoj shqipen frymëplotë. Tase e vijoi punën e vet përtej atij botimi, ndaj dorëshkrimi që m'u besua nga i biri, pasi i qe refuzuar botimi nga institucionet, qe rritur me dy të tretat, dhe ishte vërtet një visar i toskërishtes plot ngjyra.


Lënda gjuhësore besohet të jetë vjelë kryesisht nga këngët iso - polifonike të Shqipërisë së Jugut; pra, përendërtimin e tij, Tase ka zgjedhur të

transkriptojë më së shumti formën e kënduar të fjalës shqipe. Ç'vend mund të zërë kjo formë në tërësinë e mjeteve fjalore të shqipes?

Shpesh thuhet se shqipes së sotme i është mpakur melodia; mirëpo veç këtij problemi estetik, ka rëndësi të kuptohet fakti se tëhuajësimi apo vrazhdësia kanë përcaktuar deri diku dhe refraktarizimin e mjeteve të shqipes letrare kundrejt çdo mjeti tjetër që nuk i nënshtrohet plotësisht sistemit normativ.

Rikthimi i bukurtingëllimit në shqipen letrare përmes zbutjes së kësaj vrazhdësie do të thotë, në terma të gjerë gjuhësorë, edhe rizgjim i shqipes së brendi. Botimi integral i "Fjalor dialektikor", përvèç risive që sjell në fjalë, ofron edhe një visar shumë të çmuar etnolinguistik.

Në të renditen, të ndara qartë dhe pastër nga hartuesi i tij, urime të ndryshme si ato për dolli, urime përlindje; ngushëllime, mallkime, pendime pas mallkimit, fjalë fyese e sharje për cene trupore, përkëdheli-
ra, kanosje, gjëegjëza, njësi frazeologjike dhe proverba. Fjalor dialek-
tor nuk do konsideruar thjesht si një përshtafje e një vlere arkivore, por si shtim i lëndës shqipe që u ofrohet përdoruesve të sotëm.



Thekse

MEDIOKRITETI NË KRIJIMTARINË LETRARE

Duke i imituari idhujt e periferisë mediokrititet e periferisë me të drejtë shpresojnë se me shkrimet e tyre do ta befasojnë lexuesin e mjedisit të vet



Rexhep QOSJA

"... Numri i mediokriteteve në letërsitë e vogla kombëtare është, veçmas, i madh, megjithëse opinioni lexues mendon se pikërisht në letërsinë dhe kulturën e tyre nuk ka mediokritete. Disa prej mediokriteteve të këtyre letërsive e imitojnë me ngulmë letërsinë popullore ose, tekem-bramja, e shfrytëzojnë thesarin populor me qëllim që të tërheqin interesimin e opinionit – kur shkruajnë vjersha dhe proza, apo të shikuesve – kur shkruajnë drama dhe skenarë filmi. Mediokritetet e këtij interesimi pohojnë se në atë mënyrë

duan të janë autoktonë, por meqenëse janë përgjysmë të aftë, bëhen epigonë të letërsisë popullore dhe zhyten në folklorizëm dhe në primitivizëm.

Disa prej mediokriteteve të tjera të këtyre letërsive i imitojnë shkrimitarët e huaj dhe i imitojnë kryesisht dhe përfundimisht ata shkrimitarë të huaj avangardistë, që me shkrimet e tyre kanë zgjuar interesim të madh në qarqet e huaja letrare, por janë shndërruar në idhujt e qarqet periferike evropiane të letërsisë. Duke i imituari idhujt e periferisë mediokritetet e periferisë me të drejtë shpresojnë se me shkrimet e tyre do ta befasojnë lexuesin e mjedisit të vet. Mediokritetet e këtilla, zakonisht i imitojnë format kompozicionale, teknikën e shprehjes, simbole, metaforat, veçmas alegoritë, pikëpamjet, disponimet, sëmundjet nervore, apatitë dhe, përgjithësisht, inovacionet e shkrimitarëve të huaj. Mediokritetet, shpesh, përbajtjen autoktone, të biberosur me biberin e thesarit populor, e veshin në rrobet letrare të shkrimitarëve të huaj, që do të thotë se personazheve autoktonë ju presin robe allafranga. Nuk është e gjithshme, prandaj, pse shumica e personazheve të mediokriteteve, edhe kur kanë emra nacionalë, veprojnë, mendo-

jnë, sëmuren, çmenden dhe vdesin në mënyrën e huaj apo në ambiente, në të cilat më së shpeshti vdesin personazhet e disa shkrimitarëve bashkëkohorë të huaj. Po t'i hynte punës jomirënjohe të krashtasimit, çdo studijues i kujdeshëm do të shihët se sa simboli, alegoria, metafora, se sa format e disponimt, se sa atmosfera, se sa karakteri i personazhit të shkrimeve të shkrimitarëve të huaj janë shartuar artificialisht në shkrimet e disa shkrimitarëve të këtyre letërsive periferike. Të gjithë shkrimitarët, madje edhe ata me prirje më të madhe, janë të shtrënguar të pranojnë, apo të japid, ndikime, por ndryshimi ndërmjet tyre dhe mediokritetave qëndron aty se shkrimitarët që mendojnë me kokën e vet i asimilojnë, i përvetësojnë ndikimet, kurse mediokritetet ju nënshtrohen plotësisht, bëhen robër të tyre; ndryshimi ndërmjet të parëve dhe të dytëve qëndron aty se të parët krijojnë vepra artistike autoktone me disponim të papërtëritur, kurse mediokritetet, duke i shkoqur format e huaja prej kontekstit natyror, artistik, krijojnë kic-literaturë, që në periferinë evropiane shpesh pranohen si literaturë „e vërtetë“. Mediokritetet e letërsisë në të vërtetë janë epigonë. Çdo gjë të huaj, çdo

inovacion, që është inovacion vetëm brenda kontekstit ku është përdorur, ata e pranojnë, pra, pa kurrrfarë rezerve për shkak se janë të qëruar prirjesh dhe vetëdije kritike që t'ja nënshtrojnë gjykinit dhe vlerësimt të vet kritik. Përse mediokritetet e letërsisë zgresin në nivelin e epigonëve? Sipas të gjitha gjasave, ata vuajnë prej kompleksit të inferioritetit, që ua imponon vetëdija e aftësisë mesatare dhe, në përpjekje e sipër që ta sublimojnë kompleksin, ju nënshtohen imitimëve të autoriteteve të huaja letrare, të cilave, në çdo rast, në çdo situatë u gjunjëzohen, ua puthin duart, ua heqin kapelat, ua mbajnë palltot, ua listrojnë këpucët, ua brushojnë rrobet. Megjithëse shkrimet e mediokriteteve, zakonisht, përfundojnë në shportën e estetikës dhe s'mund të gjëzojnë kurrë dashurinë dhe respektin e lexuesve, historianët e letërsisë interesohen për to jo për shkak të vlerës që mund të kenë, po për shkak se përmes tyre mund t'i shohin dhe studiojnë më lehtë ndikimet e asimiluar që çdo letërsi kombëtare pranon prej letërsive të popujve të tjerë e, sidomos, prej letërsive të mëdha..."

(PANTEONI I RRALLUAR, "Rilindja", 1973)

DILEMAT E SFINKSIT NË POEZINË E ISMAIL SYLËS

Në kohën e pandemisë, Ismail Syla nxori nga shtypi librin e tij të radhës "N'pllojë marrëzie", një titull trumbetues ku percepton dilemat e Sfinksit



Mërgim Sh. BEKTESHI

Poezia është një art i fuqishëm, ku mendjet e imprehta shpërfaqia porosinë shumë përbajtjesore të aktualitetit, përmes vargut, në dy apo më shumë vargje, që përfundojnë si aksionat të qenit i vërtetë, pa ndonjë trillim, ndërkaq lexuesit i duhet një kujdes më i shtuar në lexim. Ky autor i thelluar është Ismail Syla. Ka dekada që I. Syla dhe poezia janë ngjizur simbiotikisht si atome të përbashkëta drejt një ekuacioni, gjetjen dhe sfidrimi i Sfinksit gjë gjëjzë. Në këtë kohë pandemie, Ismail Syla nxori nga shtypi librin e tij të radhës "N'pllojë marrëzie", një titull trumbetues ku percepton dilemat e Sfinksit, i sfidon ato me radhë, gjë përgjigje, kujtesa e tij është shumë hapësinore, modelon aktualitetin apo, siç thotë editori i librit, Abdullah Zeneli: "Vazhdon t'i shprehë dilemat ekzistenciale, t'i vë në pah paradokset dhe kundërthëniet e mjedisit shqiptar". Fjalorit të shqipes, sa ai që përban mbi dyzetnjë fjalë, shfletues i rregullt i të cilët është, autor i qëndron besnik, por duke shkundur pluhurin e disa fjalëve që janë të

rralla. Kujdesi ndaj gjuhës standarde është shumë i lartë, i shoqeruar me ndonjë varacion krahinor duke ruajtur kuptimin etnografik të krahinës, por që përkureshtjen e lexuesit ai e kompenzon me fusnota dhe sqarime të tjera.

Në kuptimin e shumë simbolikave që i gjejmë në poezinë e tij, sidomos ato "N'pllojë marrëzie", janë ato të natyrës së veçantë që nuk gjenden tek autorët e tjerë. Përmes frazeologjizmave të gjuhës shqipe si p.sh.: "Desh te lugu, vesh te gardhi", ai krijon poezinë që është një paradoks i kohës së sotme, askush më nuk arnon tesa se pse ato tanimë janë me bollëk. Plaja e marrëzisë është ngritur me katër kolona të ndryshme, secila me peshën e rëndesës duke shpërfaqur secila varietetet e saj me qëndisma të ndryshme, por që kanë emërues të përbashkët marrëzinë që e neverit autorin gjatë ballafaqimit me ekzistencën e qenies shqiptare. Përpos defekteve që shpërfaqen në atdheun e katandisur, ai kérkon edhe zgjidhjen racionale. Katër kolonat e mirëfillta fillojnë me kapercyell, një paradoks, bir i pranverës dhe atdheun të cilët autorri nuk

dëshiron t'i mbetet borxh për asnjë çast të vetëm. Në çdo përbledhje është Atdheu, në tri rrafshe: i ngrysur, i pabërë dhe heroik. Tema e Atdheut del në çdo libër poetik të Ismail Sylës. Në katër kolonat apo ciklet, lexuesi mund t'i gjejë poezitë që mund të janë poezi për shpirtin tij. Në poezinë "Bijtë grindarë të Zeusit", përmes figurës së paradosit autorit shfaq millefin e shqiptarit të zemëruar deri palcë e që grindjet e tyre kapérçejnë çdo limit të lejuar dhe përfat të keq nuk gjendet as një Olimp me Zeus që ato grindje t'i zbrsesë në pajtim. Me këtë krijimtar, një elan të akumuluar, Ismail Syla po arrin të prezantojë një letersi të denjë duke e kthyer vëmendjen te poezia, se ajo është art i rrallë dhe fryma filozofike e saj është tejet e vështirë të përshkruhet përmes vargut, aq më shumë kur porosia dhe ideja të janë në një trajktore përfundimtare. Po të formohej antologjia e poeziave për Atdheun, nga tre librat, përfshirë edhe librin me tetëdhjetepesë poezi ekskluzive për atdheun "Atdheu im, i ngrysur", do të dilte një libër me mbi dyqind lirika për Atdheun.

Shtegtim i një leximi poetik

SHQIPTIM POETIK I SHPIRTIT DHE I BOTËS SË NJERIUT

(Enver Visoka „NË FUND TË VERËS”, poezi, batoi LITERA, Prishtinë, 2023)

Arif MOLLIQI

Epiqendra e poeziave të këtij libri të Enver Visokës qëndron në sfidat e njeriut ndaj jetës. Por aty gjen edhe sfidën karshi vdekjes, karshi vjeshtës ose karshi fundit të një stine, të lules kamilje që për autorin simbolizon një dashuri universale, pse jo edhe të një zëri që autorit sikur i vjen nga universi. Por shpeshherë edhe kujtimet i shërbijnë si shembull për ta pasuruar poezi. Autori nëpërmes atyre rrafshave kujtmeshe, shpreh më shumë kujdes ligjërimin poetik duke e përcjellë më një gjuhë të pasur, më një strukturë të bukur vargëzimi, me shumëlloshmërinë e motiveve, dhe me stil të veçantë... Po e themi pa hamendje, poeti me "goditje" poetike s'bën kompromis për asnjë, fillim e mbarim e mbanë zjarrin ndezur, që nënkupton se mbretëria dhe forca e fjalës është e pa kufij. E jashtmra më të brendshmen ndërlidhen dhe gërshtohen nëpërmjet shpërthimeve, por me një emërues të përbashkët; poeti e urren të shëmtuarën dhe të padrejtë që çdo ditë i kanoset njeriut për t'ia rrënuar shpirtin. Midis poeziave, që tashmë është bërë traditë të krijuhen ndarje, edhe në këtë dorëshkrim emërtimi, krijimi dhe radhitja e ciklevës, është bërë sipas një koncepti të caktuar: niset më poezinë "Rrëfimi I" (që e përsëritë tri herë), që mund të merret si poezi kredo i një fillimi-hyrëse, ose si para fillim, duke

na lënë një amanet-një tip porosie përveten, dhe shkojmë gjatë poezi përbillyse "Dhoma pa mure". Fillimi: "unë thash: jo, jo mua ma shpërndani pluhurin e eshtrave në vargje, me to kam kaluar pjesën më të dhimbshme të jetës, dhe e tëra nuk ishte kjo..." Por jo vetëm kjo, shumica e poeziave të Enverit, janë si porosi dhe rrëfime të vjetvete, trajtim i jetës konkrete brenda botës më të cilën ai lufton, e kjo hetohet edhe kur poeti në disa raste thotë "unë isha", dhe e krahason veten me furtunën, natën, drithën, qellin, dielli, erën, vullkanin, shiu, oqeanin. Këto fenomene mbin-jerëzore sikur do t'i përdorë vetëm përvete, për qëllimet egoiste. Prandaj këto poezi kërkijnë një lexim aktiv, një përqendrim të shtuar. Këtë gjë e kushtëzon struktura e veçantë e vargëzimit, prej se ciliës dalin vargje, ose fjalë shumëkuptimshme, që përherë përplasen dhe zgjojnë enigmën përvete, që ta zbuluar fshehtësinë që e kanë brenda këto poezi. Kjo gjendje e këtyre poeziave nuk mbyllët rastësisht më poezinë "Dhoma pa mure", ku gjithçka na del e kushtëzuar dhe e varur nga imazhe meditative herë-herë tronditëse por përsëri të kapshme. "...Ruana o Zot nga ata që i dinë të gjitha..." A s'ka lidhshmëri porosia e poetit kur në fillim thotë: "...mua ma shpërndani pluhurin e eshtrave në vargje..." më poez-

inë përbillyse: "që të gjallët ta kenë më lehtë t'i kujtojnë", që nënkuptojnë: si fillimi i jetës ashtu edhe mbarimi i saj, janë flujim. Sado që të dy variantet kanë trajta simbole, ato nuk janë të idealizuara. Midis këtyre dy fillim-mbarimeve, midis poeziave së parë dhe asaj të fundit, gjinden poezitë e tjetra, të ndara në cikle: "Nën petalet e lules kamiljes", "Stina e shpirtit", "Në fund të verës", "Pas perdeve të kohës" dhe "Dhoma pa mure", që korrespondojnë në mënyrë të pamëdyshtë më qenësinë dhe vlerat e poeziave tjetra, e që janë të lidhura me botën e brendshme të autorit dhe njeriut në përgjithësi, me një art të madh vargëzimi. Si e tillë, poezi e përfshirë në këtë dorëshkrim dëshmon se Enver Visoka hyn njëmend në radhën e poetëve që poezinë dhe porosinë e saj e shkruan seriozisht. Poezi e Enver Visokës me strukturën e veçantë poetike, me nëntekstin e shumtë dhe të pasur poetik, apriori na jep alternativa të shumta interpretimi, ajo afro mundësi të shumta të imaginatës përvete, para se gjithash, dashurinë ("jetës ia nisim nga fillimi/e bardha e bukur Leonorë", ose: "më shqafet kurumi yt i hollë/si t'i shmangemi vdekjes Leonorë!..."), brenda botës individuale dhe universale të njeriut. Mirëpo, fshehtësitë e saj, sidomos ato që gjenden brenda hermetikes, shpesh të paftësishë së lexuesit përvete, na jepin me kuptuar se poeti shumë rëndësi i ka kushtuar



botës subjektive. Këtë strategji krijuese ky poet e zbaton shpesh, prandaj lexuesi shpesh ballafaqohet me poezi të tillë. Sidoqoftë, këto poezi janë një shqiptim poetik thelbësor i shpirtit dhe i botës së njeriut, që shpalosin dilemat jetësore: të fatit, të durimit, të vetëdijes që e ka të shtresuar autorit nga një përvvojë krijuese. Poeti qëmton me ngulm dhe realizon me shkakthësi mënyrën e të shkruarit, duke na dhënë një mesazh poetik të qëndrueshmë. Ç'është e vërteta, në shumë poezi ai bën objekt shqyrtimi vjetveten përmes fjalës, si formë e shqiptimit të vetëdijes, të përplasjeve shpirtërore e mendore. Pa e vënë pikën në fund të këtij libri, ne vetëm kemi vënë gurthin e parë përvlerën e këtij mozaiku poetik në mendimin se gama e këtyre poeziave është e gjërë, e pasur, por edhe e trishtë.

MIGJENI DHE LETËRSIA MBI FËMIJËT

Zeneli, ashtu si Luli i Vocërr janë produkte reale të një realiteti tragjik. Dhe realja nuk është fatale, përkundrazi është pasqyrim konkret, pa zbukurime i realitetit. Të rralla janë këto modele ligjërimore me personazhe, si: Luli i Vocërr dhe Zeneli

Xhahid BUSHATI

Më 1936 Migjeni mundi të botonte të vetmen vepër, përbledhjen "Vargjet e lira", e cila u ndalua nga censura. Libri u botua rishtazi e qarkulloi më 1944. Disa nga vjershat e prozat e tij, kishin vlera të veçanta ideoartistike, kapeshin lehtë edhe nga lexuesi i vogël, ndaj zunë vend në tekstet e këndimeve e të leximeve letrare të arsimit bazë dhe u bënë shumë të dashura për nxënësit e shkollave tona. Përmendim: "Luli i Vocërr", "Zeneli" etj. Migjeni krijoi një galeri tipash të fëmijëve të vegjilisë nga fshati dhe qyteti. Për rrjedhojë, u bë nismëtar i letërsisë realiste shqiptare për fëmijë, një nga themeluesit e prozës moderne për moshat e reja. Pas Çlirimit, me pjesë poetike e prozë të zgjedhur nga vepra e Migjenit, u botuan përbledhje të cilat u adresoheshin lexuesve të moshës së njomë: - "Luli i Vocërr" - NSHB, Tiranë 1957; - lektyrë shkollore shk. 6, Libri Shkollor, Prishtinë 1968, 1970, 1972, 1998; - lektyrë shkollore shk. 6: NASHA KNIGA, Shkup 1977, 1989, 1990; Çabej, Tetovë 2003; Gutenberg, Prishtinë 2009. Po përmendim edhe disa krijime të Migjenit që hyn në leximet për fëmijë e të rinj, të botura në organet e asaj kohe: - Në revistën "Illyria", më 15 korrik 1934, V.I, nr. 19 botohet "Një refren i qytetit t'em"; Në "Jeta dhe kultura", 20 korrik 1935, V.I, nr. 3, botohet "Moll'e ndalueme"; Në "Illyria", 18 qershor 1936, V.I, nr. 39, botohet "Luli i Vocërr"; Në "Bota e Re", 15 maj 1936, V.I, nr. 3, botohet "Zoti të dhashtë"; Në "Bota e Re", 15 tetor 1936, V.I, nr. 13, botohet "Legjenda e misrit"; Në "Bota e Re", V.I, nr. 17, botohet "Bukuria që vret"; Në "Përpjekja shqiptare", 24 dhjetor 1938, V.II, nr. 18, botohet pas vdekjes "Zeneli". (shih dhe shënimet e Prof. as. Dr. Astrit Bishqemit).

Migjeni e filloi mësuesinë në Pukë më 18.04.1936. Dha mësim në klasën e tretë dhe të katërt. Në klasën e tretë realizoi këto programe: hartim, drejtshkrim, aritmetikë, bukurshkrim, vizatim, këngë dhe gjimnastikë. Ndërsa në klasën e katër realizoi këto programe: mësim moral e qytetar, hartim, drejtshkrim, gramatikë, aritmetikë, bukurshkrim, vizatim, këngë dhe gjimnastikë.



E, duke mbetur në mjediset e këtyre dy klasave, nuk ka sesi të mos kujtojmë vocrakët-nxënës, e në mes tyre Lulin e Voçërr dhe Zenelin, që u përfjetësan në skicat letrare si rrëfime mrekullie nga mësuesi i tyre shkrimtar. Këtu, do të pohojmë mendimin e prof. Bedri Dedjes, me të cilin ndajmë një mendje, se mënyra e strukturimit dhe ligjërimit të tekstit i takon letërsisë mbi fëmijët.

Luli i Vocërr është një personazh i dashtun i Migjenit, aq i dashtun sa bota e tij vërtitare dhe e trishtuar plotëson e vijimëson botën e Migjenit të Madh. Migjeni e ndjek Lulin artistikisht hap pas hapi. Operon me çdo detaj. Çdo detaj është i dhimbshëm i përvajshëm. Ata vizatojnë gjendjen shpirtërore të Lulit, që veç Migjeni e njeh, që veç Migjeni e di. Për rrjedhojë, kjo

marrëdhënie ka aq afri sa mbetet një model dashurie dhe frymëzimi. Luli është i pjekur para kohe. E ka pjekë varfëria, mjerimi. Edhe pse diku në një qoshe, teksa i buzëqesh një rrezeje të dobët; ai në shpirt ka ruajtur një tufë me èndrra jo përveten, por mësuesin, Migjenin e tij të dashtun. "Nganjëherë i afrohet mësuesi Lulit. Dhe kur e ka fytyrën e diartë dhe pa puça, mësuesi ja ledhaton faqet, gushën, e Luli i afrohet, ia merr dorën, e shikon me sy pëllumbi dhe kishte dashtë t'i fali diçka mësuesit. Por vjollca nuk ka. E Luli i Vocërr ç'ka mund t'i fali mësuesit tjetër? Veç në ja faltë tollumbat e veta që kanë hapun gojën si me dashtë me hangë mësuesin. Po, po, tollumbat e Lulit të Vocërr kanë me e hangë mësuesin". E kështu në dimensionin artistik:

mbeten, ashtu, pranë e pranë Luli i dashtun dhe Migjeni i dashtun. Një dashtunim që i bën sfidë mjerimit, por edhe një model edukativ, një model moral i ndjenjës dhe pastërtisë njerëzore. Njerëzorja e përkundrazi fund ligjërimin për Lulin e Vocërr. Po me të njëjtën pamje atë të njerëzores, por në një dimension e rrafsh tjetër, është parë nga mësuesi figura e Zenelit. Në disa aspekte Zeneli plotëson Lulin, por ka disa të përvëçme, si: është i zgjuar, guximtar dhe trim. "Mjaft ma, Zotni mësues, mjaft na mësuet si duhet me jetue, çka asht mirë e bukur mjaft na mësuet, - megjithatë na po rrojmö si rrojtë stërgjyshnit tanë, po në ato gjëzime e po në ato mjerime, të lanun e të tretun ndër këto bjeshkë. Qe na shiko një herë, njenit nepër kmishtë të shkyerme i shifet supi i verdhë, tjetrit barku si drrasë, atij atje asht gati t'i bjerë të fikët nga uria, një tjetër prap mermezi përmbahet mos t'i bajnë, dhambët brrr nga ethet..". I gjithë ky fragment tronditës e tragjik i vendosur në gojën e Zenelit, që vetë është një personazh tragjik, zbulohet realisht realiteti që askush nuk mund ta përkruante më bukur sesa pena e Migjenit. Para fjalëve të Zenelit kalojnë shokët e tij bashkëmoshatarë: të piktuar dridhshëm e të detajuar qartazi. Rrallë mund të ketë piktura të tilla, ku sundojnë kufijtë fëminorë e arsyetimet e tyre dalin jashtë këtyre kufijve. Karakteristika e dytë e Zenelit është se, ai është inteligjent. Është personifikim i Dritës së Diturisë. Vetë, Zeneli është dhimbje e trishtim real. Vetë Zeneli është një èndërrimtar dhe këtë èndërrim e kérkon jo vetëm përtë sotmen por edhe përtë nesërmen, të nesërmen përtë ta realizuar. Ndaj ai sjell fakte e dukuri. I faktion ata me momente të trishta nga realiteti. "S'kemi kurrgja, Zotni, as vegla të reja për punë, as shtëpia higjenike të mira si në shtetet e tjera jemi të vegjël". Zeneli, ashtu si Luli i Vocërr janë produkte reale të një realiteti tragjik. Dhe realja nuk është fatale, përkundrazi është pasqyrim konkret, pa zbukurime i realitetit. Të rralla janë këto modele ligjërimore me personazhe, si: Luli i Vocërr dhe Zeneli. Vetëm madhështia e talentit të Migjenit shkon në kohë e përtej kohës. Nuk është krijues i përkrimimit por i sintezës. Migjeni është i gjithëkohshëm.

ZHVENDOSJA E KONTEKSTIT SI NDJESI, INDIVIDUALJA DHE KOLEKTIVJA

Gjithë vepra e tij poetike "Lum Lumi" ka grishje deri në profetike, sepse bart me vete një kompozicion të tërë ndjenjash që trazojnë qenien e poetit, turbullojnë mendimet dhe shumëfishojnë mundimet e tij


Majlinda Nana RAMA

Vëllimi "Lum Lumi" është një ndër veprat e majave të poezisë sonë kombëtare. Poeti, nga simbolika e dhimbjes së madhe horizonteve të atdheut, mblidhet e hyn në dhimbjen e afërt, atë më intime, më personale. Në këtë vëllim ai shfaqet mes dy trazimeve jetëmarrëse, ku njëra merr fuqi e del mbi tjetrën, por assesi nuk mbetet vetëm. Çështja e ekzistencës vjen e bëhet më e ndjeshme, më e mprehtë. Vihen pranë e pranë vdekja dhejeta, ku kjo e fundit - e pamundur, e pafuqishme - i jetet vdekjes përditë nga pak, e vdekja, përditë e nga pak, po ashtu, gërryen si pika e ujit mbi gur.

Është një përcjellje tragjike e rrethanës reale kjo, sepse është shumë pranë poetit, nuk i qëndron si fenomen që ai e sheh në distancë dhe ia ndien dhimbjen. Tani jetëvdekja i vallëzon para syve e i hyn dhunshëm në asht. Dhimbja për sëmundjen e të birit, Lum Podrimes, është pikë e nistore e një pikëllimi të ri, që, sidoqoftë, megjithëse pak më në distancë, i shtohet pikëllimit ekzistues të poetit përfat e vendit. Duke e kaluar këtë të fundit disi në plan të dytë, ai e mban përherë me vete, teksha djalit i thotë se mund të vdesë, por të vdesë përfat Palestinën, me të cilën nënkuption Kosovën. Pra, të dyja këto fate i sheh si binom që duhet t'i mbajë plagë të pambyllura, përherë të hapura e me vete.

Dikund në fushat e djegura të Sremit
dikund në pyjet e errta të Sharrit
Ra luftëtar i ynë i lirisë

Mbyllt përf një çast rrathi, aq sa duket se bëhet vicioz, e poeti nuk përpinqet të zgjedhë fjalë e figura, nuk ka as fuqi ta bëjë këtë, e duket se vdekja nuk i jep më kohë jetës së të birit. I gjendur në këto kushte, dérrmuar, rënë e përkulur përparrë fatkeqësisë së madhe që po i rrëmben gjakun e genin, shpirtin e shpirtit, ai i drejtobet në



vetën e dytë:

Ti heq shpirt me kokë në jastëk turp vogëlushi

Im

Është turp që raca shqiptare ta humbë kohën duke vdekur në shtratin e shtruar me dafina e gjethë plepi dhe prehrin e ngrohtë të nënës. Trimat vdesin atje, në fushëbetëjë, vdesin përfçështje të mëdha kombëtare. Atje duhet të shkonte edhe i biri e le të vdiste përfat e vet, përtokën e tij amë.

Ke mundur tek e fundit të ngjeshësh armët e Asimit
E të shkosh në Bejrut

Të vdesësh përfat Palestinë

("Të shkosh në Bejrut")

Shohim se si poeti krijon mbivendosje dhimbjesh, fatesh e ngjarjesh.

Shoqërorja, kolektivja - shtresë e parë, më e hershme, ndërsa

individualja - thikë përmbi të. Sepse ky është poeti Ali Podrim, ky është autor i vargut himnizues të vendit të vet e rracës së sojtit të tij. Ndërkohë, i pushtuar në lotët përfat Lumin, poeti kërkon t'i shpjegohet birit të vet se një burrë nuk mund të derdhë lot. Vdekja nuk duhet t'i mposhtë njerëzit, sipas logjikës së poetit. Dhe i justifikohet me metaforën që ngjall vdekja si proces. Proses të cilin Mensur Raifi do ta artikulonte: "Pavdekshmëria nuk është iluzion i ikjes nga defetizmi përf tu futur në legjendë, por qëndrim burrëror ndaj vdekjes që inicon një mësim përfatën".

unë nuk qaj
shi bie
vogëlushi im
shkundet plepi i shtëpisë...

Gjithë shtëpia është dhe s'është.
Tunden themel, tronditen

muret, shemben dritat, gjithë plepi i bleruar i asaj shtëpie shkundet e rrëzon para kohe gjethet e saporritura, të paprekura ende.

Është një atmosferë kobi e dhimbjeje që edhe muret që s'kanë gojë, do t'u duhej ta rrëfen... Dhe ja, pas luftës së madhe me fatin e veten, i biri i pafajshëm, dorëzohet, heq dorë nga dëshira përfat jetuar, ikën duke lënë pas malin e rendë të pikëllimit, gurgullimat e lotit që zgjasin me shekuj deri në përfjetësi.

Ike
nga dëshira
përfat jetuar
por
të gjallët
ende s'ile të qetë.

Të gjallëve (poetit...) ua prishi qetësinë, ua prishi jetën, ua trazoi shpirtin.

Trimat nuk vajtohen
Paç dritë në mretërinë tënde
të humbur.

Gjithë vepra e tij poetike "Lum Lumi" ka grishje deri në profetike, sepse bart me vete një kompozicion të tërë ndjenjash që trazojnë qenien e poetit, turbullojnë mendimet dhe shumëfishojnë mundimet e tij. Kjo vepër ka në thelb një vocation dramatik më të gjërë, atë të njeriut nëpër kohë - një brengë-trishtim, një rraskapitje e qenies njerëzore që mbetet dert i përfjetshëm. Kuptohet që Podrim, veç të vërtetës së vet, siç e thamë më lart, ka sjellë me vetëdije atë që ia dérrmon shpirtin çdo shqiptari të përgjegjshëm, robërinë dhe zgjedhën e përhershme. Prandaj zëri i Podrimës shfaqet original në memorien, psikologjinë dhe qenien e njerëzimit. Është zë përfnjeriun. Është zëri qytetar.

Është dritarja që unifikon lotin vetjak me lotin e masës, lot që nuk thahet e endet në pritje që luftërat njerëzore të mbarojnë (luftëra të cilat, përfat e keq të poetit dhe vendit të tij, duket se nuk mbaronin kurrë).

KOHË FILMAXHINJËSH DHE TEATRALESH

Teatralët vdesin si në teatër, përngjashëm me protestuesin e lyer me bojë të kuqe, që turma e merr si të vrarë. Ju kujtohet kur Rama i drejtohej Lulit me nofkën "artisti" dhe ai përtetuar, vinte një tabelë para vetes: "Unë jam teatri"?



Fatbardh AMURSI

Në Shqipëri dominojnë dy tipa të së njëjtës medalje, që, hedhin topa bore mes tyre, ku guri rri i fshehur: filmaxhijtë dhe teatralët, të cilët i gjeni me shumicë në tregun politik, mediatik e në atë të artit. Doemos dhe në facebook. Si njëri dhe tjetri janë në rol dhe, kur qëllon t'i shohësh duke u grindur, ku goja u kthehet në jashtëqitje, merre me sportivitet, bëjnë filma, luajnë teatër. Në mesin e atyre me maska, nëse ke fytyrën tënde, hall të madh hedh mbi vete. (Nëse filmaxhijtë u turrën t'i vinin flakën BunkArtit, teatralët u bën gardh në mbrojtje të teatrit të vjetër, i njohur ky si bastion i fundit i realizmit socialist, që këta e bëjnë rezil.) Teatralët vdesin si në teatër, përngjashëm me protestuesin e lyer me bojë të kuqe, që turma e merr si të vrarë. Ju kujtohet kur Rama i drejtohej Lulit me nofkën "artisti" dhe ai përtetuar, vinte një tabelë para vetes: "Unë jam teatri"? Kam bërë një shkrim atëherë me titull "Teatër me teatrin", mu turrën filmaxhijtë dhe teatralët, ngaqë besonin se Luli do t'i vinte gjoksin fadromës, duke na sjellë në kujtesë Mic Sokolin! "Shoku Enver ka luajtur ndonjëherë në teatër?"-do pyeste Duro Shehu, i vëllai i ish kryeministrit shqiptar. "Kam luajtur në teatrin e Korçës."-iu përgjigj Hoxha. Luajti teatër ai, sa i desh bytha. Tani merren me prapanicën e tij. Meqë jemi këtu, gjyqet e montuara, të inskenuara me dëshmitarë të rrremë a nuk ta kujtojnë teatrin? Sikurse dihet, filmaxhijtë nuk shpenzuant asnjë sekuencë trimërie në mbrojtje të kinostudios, edhe kur po kérkohej ndalimi i filmave të kinostudios "Shqipëria e

re", s'ngriten alarmin se po zhdukej kujtesa kulturore, sikurse teatralët bënë me godinën e amortizuar. Si mund të ndodh kjo, kur filmaxhijtë dhe teatralët janë dy anë të së njëjtës medalje?!
Pikërisht njëri nga mbrojtësit e flaktë të teatrit, faqet e para të romanit ia kushton mizorisë kryeministrore në shembjen e teatrit të vjetër, ta rrëzojmë të gjatin, së bashku me një regjisori bashkëvajtës u shfaqen në zyrën e "kryeministrit diktator" për të kërkuar mbështetje financiare për një film kushtuar vuajtësve në burgjet e diktaturës. Thua se cjapi po shkonte tek kasapi?! Krejt pa lidhje të akuzosh një skenarist dhe një regjisori për tradhti, pse po i kérkojnë kryeministrit të shqiptarëve para, kur ai u ka paguar këstet e burgut, ka ngritur muzeun "Shtëpia e gjethive", sikurse po investohet për Spaçin famëkeq?! Sikurse shihet "grupet e interesit" janë për një qëllim. (Vetëm Enver Hoxha nuk merrte kredi tek kapitalistët.) Me sa duket Ramën e shohin si pinjoll të atyre që vranë dhe varën, ndoshta prania e skenaristit u kujton poezinë "A janë bërë më të mirë vrasësit tanë"! Mos po rehabilitojnë Edvin Kristaq Ramën, ka të ngjarë të jetë shqetësimi i bashkëvajtësve. (Nëse ti s'je tradhtar apo spiun, kjo nuk do të thotë që s'mund të jesh i pabesë, filmaxhi apo teatral. Njëherë e një kohë Rama citonte një fjälë të urtë malësorësh: "I pabesi është më i keq nga hasmi.") "Autori, (është fjala për skenariston,) nuk thekson pothuaj asgjë mbi faljen e xhelatëve, që kurrë nuk kérkuant falje. Por, pranon kokulur, besëprerë dhe me kandil shprese, se në kushtet ku gjendemi nuk bëjmë dot pa paratë e tyre."-rea-

gon një adhuruese. Personalisht, ky reagim mu duk një vetëmashtrim, ngaqë lë të kuptohet se opozita, na qenkësh në pikë të hallit, me xhepa të shpuar, s'kanë faktët të sponsorizojnë autorë të persekuatuar, edhe pse kullat po i ngrenë në kupë të qelli?! Është folur shpesh për shpenzimet e tyre marramendëse në fushata, në TV, pavarësisht se predikuan "autobusin falas". Në autobus janë akoma. (Ende s'po e kuptojnë se betejat e opozitës janë të trkuara me ndeshje të shitura. Më i singertë më duket deputeti Saimir Korreshi me ato daljet shou, që shkaktojnë humor me qesh e njëjsh.)
Rama ua premtoi parat sapo ata hapën gojën, i bindur se sponsorizimi më shumë se sa përfilm do ishte një investim përmazhin e tij. Nuk thonë këtë: ai që të shan të do?! "Hallall Komendant! Si gjithmonë dy lëvizje para kundërshtarit në shah!"-do thoshte Tërmeti, nipi i "komandanit lab". Po ty ziliqar, sa të qenka bërë qejfi, që marifetxhiu Rama, e luajti pjesën dhe e përdori dëshirën e mirë të të vuajturve për interesat e pushtetit? Si të mos gjëzo hem, kur mua më ka dalë namë se e mbështes "kryeministrin që duam", të cilit po i shërbejnë me zell ata që s'e duan? Do të thoni ju, që noc rokun ke marr prej tij, o "revanshist i realizmit socialist", "oficer rezervist i zboreve", që ke marrë dhe leje krijuese nga Lidhja e Shkrimitarëve, kur shokët e tu kalbeshin burgjeve?! Po, mor po, unë jam i keqi, vazhdoni t'i bini legenit, që me raste e përdoni dhe si helmet?!

Përtej imoralitetit të kohës, të vërtetave që therin, pakënaqësisë personale, uroj që filmi të përmbysh pritshmëritë e publikut, të arrijë

suksesin historik, sikurse e parathotë dhe Evi Kokolari, qoftë dhe një nismë për pajtimin kombëtar, por, kurioz të dija: autori i poezisë "A u bënë më të mirë vrasësit tanë?", ka ndërruar gjë mendje, meqë i biri i Kristaq Ramës firmëtar i varjes së poetit Havzi Nelaj, që mungon dhe në antologjinë rumune, veç kësteve të burgut i dha skenaristit pension të veçantë, e çoi tek Papa duke bërë sherr me të ndjerin president, në OKB më pas, tani po i sponsorizon dhe skenarin, është tjetër nga ai që shajnë të vetët?! Më bën përshtypje ca sugjerime, sidomos kur thuhej që në xhirime të thirreshin të aktronin dhe ish të burgosur, që sipas tyre: do ta bën filmin të veçantë. Nuk di a ka në skenar bashkëpunëtorë të sigurimit të shtetit nga radhët e të burgosurve, nëse po, s' do ishte keq të ftosheshin dhe ata të luanin veter. (Të burgosurit bën aktivitete artistike në burg, luanin dhe estradë.) Meqë dikur ata me "biografi të mirë" luanin rolet pozitive, tani me një realitet të përbysur ishëve u takon të luajnë rolet e komandës së burgut, të ofiqarëve shtetëror dhe s' do ishte keq t'i bën një ftesë ca opinioniste, në mos dhe ndonjë komandanti burgu ende gjallë. Meqë Rama akuzohet si diktator, koka e mafies, nip i byroistit, se mos i taksin rolin e komandantit të burgut? (E pamë të luante në një film të Mamaqit. Fundja, ky nuk bën sikurse, me gjasme.) E sikletshme do jetë dhe për një arsyet tjetër. Ministra, kryetarë bashkë, drejtore institucionesh i ka në burg, po sikur t'u shtohet Sala me Metën, thonë se këta e mbajnë në pushtet bashkë me Lulin, a do i bëjnë këmbët Ramës ta heqë këtë valle me pranga?! Jemi në Tironë, çdo gjë mund të ndodh! (Filmi i parë, ku rolin kryesor e kishte një i burgo-sur është "Dora e ngrohtë" me skenar të Neshat Tozajt, shkrimitar nga radhët e punonjësve të Ministrisë së Brendshme në sektorin e kriminalistikës, bazuar në romanin e tij "Thikat" me parathënie të Ismail Kadaresë, i botuar na Francë dhe në Greqi. Nuk mund të mos bëj përshtypje ndryshimi i titullit nga "Thikat" tek "Dora e ngrohtë", pavarësisht se si bajoneta dhe foleja e fishekut kanë po ato raporte, sikurse filmaxhijtë me teatralët. Mos vallë kjo lloji "dore e ngrohtë" iu zgjat dhe autorëve të filmit, të cilët panë tek kryeministri, i akuzuar për shembjen e teatrit të vjetër, një "artist dhe mik"?! E po të bësh filmë pa kinostudio, sikundër bëjnë filmaxhijtë dhe teatralët, është një arritje e madhe e kohës virtuale? S'kemi pse ua hamë hakun. Kjo është koha e tyre...

KOTËSIA E ARTIT

Arti është i padobishëm - sidomos kur krahasohet me, le të themi, punën e mjekut, inxhinierit rrugor. Por, a është padobishmëria gjë e keqe? A do të thotë mungesa e qëllimit praktik se librat dhe pikturat dhe kuartetet janë thjesht humbje e kohës sonë? Shumë njerëz mendojnë kështu.

Pol OSTER

Unë nuk di përse e bëj këtë që bëj. Nëse do dija, ndoshta nuk do ndija dëshirë më ta bëj. E vetrnja gjë që mund të them, padyshim, është se qysh në fëmijëri e kam ndier këtë nevojë. Jam duke folur për të shkruarit, posaçërisht të shkruarit si mënyrë e tregimit të tregimeve, tregimeve imaginare, të cilat kurrë nuk kanë ndodhur në atë që e quajmë botë reale. Me siguri se kjo është mënyrë e çuditishme e kalimit të jetës - të qëndroni i ulur në vetminë e dhormës me laps në dorë, orë pas ore, ditë pas dite, vit pas viti, duke u munduar për t'i renditur fjalët në fleta përti i dhënë jetë asaj që nuk ekziston - përvrëc në kokën tënde. Përse në botë do donte dikush të bëjë një gjë të tillë? E vetrnja përgjigje që kam: sepse duhet, sepse nuk ke zgjidhje. Nevoja të krijosh, të jesh inventiv është padyshim impuls bazë human. Por me çfarë qëllimi?

Për çfarë qëllimi i shërbën arti, në veçanti arti i fiksionit, asaj që e quajmë botë reale? Nuk mund të kujtoj asnjë - sidomos në aspektin praktik të përdorimit. Libri kurrë nuk e ka ushqyer stomakun e fëmijës së uritur. Libri kurrë nuk e ka ndaluar fishekun nga futja në trupin e viktimsë së vrarë. Libri kurrë nuk e ka ndaluar bombën të mos bie në civilët e pafajshëm në mes të luftës. Disa dëshirojnë të besojnë se admirimi i mirëfilltë mund të na bëjnë në të vërtetë njerëz më të mirë, më të drejtë, më të moralshëm, më të ndjeshëm, më të kuptueshëm. Ndoshta (kjo) është e vërtetë - në raste të rralla, të izoluara. Por të mos harrojmë se hapat e para në jetë Hitleri i bëri si artist. Tiranët dhe diktatorët lexojnë novelë. Vrasësit në burgje lexojnë novelë. Kush atëherë mund të thotë se ata nuk e nxjerrin të njëjtën kënaqësi nga leximi i librave siç bën kushdo tjetër?

Me fjalë të tjera, arti është i padobishëm - sidomos kur krahasohet me, le të themi, punën e mjekut, inxhinierit rrugor. Por, a është padobishmëria gjë e keqe? A do të thotë mungesa e qëllimit praktik se librat dhe pikturat dhe kuartetet janë thjesht humbje e kohës sonë? Shumë njerëz mendojnë kështu. Por unë do të diskutojo që pikërisht padobishmëria është në të vërtetë ajo që i jep vlerë artit - kështu që krijimi i artit është ajo që na dallon nga krijesat tjera që banojnë në këtë planet, ajo që thelbësisht na përkufizon si njerëz. Të bësh diçka për hir të kënaqësisë dhe bukurisë që buron nga puna e tillë. Mendoni për mundin e investuar, orët e gjata të praktikes dhe disiplinës që nevojiten për t'u bërë pianist apo kërcimtar i merituar. I tërë mundi dhe puna e rëndë, të gjitha sakrificat për të arritur tek diçka që është tërësisht dhe parimisht... e padobishme.

Fiksioni, sidooftë, ekziston në një rrjedhë që e dallon prej arteve tjera.

Mediumi i tij është gjuha, ndërsa gjuha është diçka që ne ndajmë me të tjerët, që e kemi gjithë të përbashkët. Prej momentit kur mësojmë të flasim, ne fillojmë të nxismë etje për tregime. Ata prej nesh të cilët i kujtojnë fëmijëritë tonë me shumë tëndje rikujtojnë momentin e tregimeve të gjumit - kur nënët dhe etërit tanë uleshin pranë nesh në gjysmëterrë dhe lexonin nga libri i përrallave. Ato prej nesh që janë tanë prindër nuk do ta kenë vështirë të kapin atë vëmendjen e zgjuar në sytë e fëmijëve të vet kur ua lexojmë tregimet. Përse ekziston kjo dëshirë intensive për të dëgjuar? Përrallat janë shpesh të frikshme dhe të dhunshme, me skena të kokë-këputjeve, kanibalizëm, transformime groteske dhe magji mizore. Dikush do mendonte se një material i tillë do ishte shumë i frikshëm për një fëmijë - por këto tregime pikërisht mundësojnë që fëmija të përjetojë ballafaqimin me frikët e veta dhe afshet, fërkimet dhe përplasjet e brendshme - një rrethim që sigurt dhe të mbrojtur. Kjo është magjia e tregimeve, ato mund të na tërheqin deri në thellësitet e ferrit, por në fund ato janë të padëmshme. Vjetrohemë, por nuk ndryshojmë. Bëhemë më të sofistikuar, por në fund fillojmë të ngjajmë vëvetveset në rini, me dëshirë të dëgjojmë tregimin në vijim, e kështu me rrallë. Vite me radhë, në çdo shtet të botës perëndimore, artikuj pas artikujsh botaohen duke ndriçuar faktin se më pak e më pak njerëz lexojnë libra, se kemi hyrë në atë që disa e quajnë periudha "post-literate". Kjo mund të jetë e vërtetë, por në të njëjtën kohë kjo nuk e ka zvogëluar pasionin universal për tregime. Novelat, më në fund, nuk janë i vetmi burim.

Filmat dhe televizioni, madje edhe stripet prodhojnë narracione fiktive në përmasa të mëdha dhe publiku vazhdon ti pranoj me kënaqësi të madhe. Atyre ato u nevojiten ato po aq sa ushqimi dhe pavarësisht se si tregimet mund të prezantohen - qoftë në faqe të shtypura apo ekran televiziv - do të ishte e pamundur të paramendojmë jetën pa to. Por, kur flasim për gjendjen e novelës, të ardhmes së novelës, ndihem optimist. Shifrat nuk janë të vlefshme kur flasim për libra - sepse ekziston vetëm një lexues, për çdo herë vetëm një lexues. Kjo shpjegon fuqinë e posaçme të novelës, e cila sipas mendimit tim, kurrë nuk do të vdesë si formë. Çdo novelë është bashkëpunim i barabartë në mes të lexuesit dhe shkrimitarit dhe është i vetmi vend në botë ku dy të huaj mund të takohen në rrethana të intimitet absolut. Mua më ka kaluar jeta në bisedime me njerëzit që kurrë nuk i kam parë, me njerëz që kurrë nuk do t'i shoh dhe shpresoj të vazhdoj deri në ditën kur të më ndalet fryma. Kjo është e vetrnja punë të cilën çdoherë e kam dashur.

(Përktheu: Gj. Osmani)



Poezi: Astrit BYTYÇI

KLITHJA E PROFETIT

Mos pritni nga unë shpëtimin
Perëndia gjendet në shpirtin tuaj
Paraja gjendet në zemrën tuaj
Ferri gjendet në mendjen tuaj
Satana gjendet në fjalën tuaj

Mos kërkoni nga unë armashimin
Jam vetëm busulla juaj

NJË DITË DO TË RRITET BARI

Kujtimet janë fletë që shlyhen
Janë jehonë e largët e shiut
Janë gjethë që i luhatë era

kujtimet janë copa dheu
mbi të cilat rritet bari
edhe mbi mua

një ditë

PORTRET

Fytyra – vjeshtë
Flokët – gjethe që shushurijnë
Sytë – tallaz të shqetësuar
Katarakt që ndjell vërvshimë

Klithja – këngë mjellme
Pritja – heshtje që vret
Fjala – zë heshtjeje
Heshtja – sinjal që thërret

Mendimet – sqota të tërbuara
Shikimi – rrymë që s'fal
Hija – sirenë e trishtuar
Gjurmët pështhymë e tharë

Fytyra – vjeshtë
Flokët – gjethe që shushurijnë
Sytë – tallaz të shqetësuar
Dashuri – èndërr e flijuar
Uragan që sjell vërvshimë

DET I TRAZUAR

S'frikohen pulëbardhat nga tërbimi
Det i trazuar

As rimat e ëmbla Në vargjet e rrudhosura
S'kanë muzikalitet

Ikën fluturimthi në humbëtirë
Pulëbardhat
Krokatjet shuan

Valë të vetmuara përpiken në ty
Det i trazuar

'92

MASHTIMI

Frymon fillkat
në humbëtirat enigmatike
i mospërfillur

Imagjinon fundin
e fillit të shpresuar
i sfilitur

E në pelegrinin e vonuar
ecajakja e boshatisur peshon rëndë

Un-i
im i mashtuar

'93

ëndërr e zezëjeta
në këtë qeli të lagësht pa numër
ku me sy të përqargët vdekja
për vrimë të çelësit kundron

Ç'të bëjmë
Me se të mas kohën
Ditët
Orët
Minutat
Me vizitat ndëshkuese të vizitorëve të paftuar
Me pikat e gjakut që i spërkat muret
Me frymën e mushkërive të sëmura

E këtu gjithçka është e huaj në mënyrën e vet
Ajri vizionet e dyert e rënda
Taku i këpucëve të lustruara
Pasqyrë e vuajtjes së njerëzve

Këtu gjithçka është e imponuar në mënyrën e vet
Hapësira lëvizja iluzioni

DO TË VIJË NJË NJERI

Një ditë
Do të vijë një njeri
Thonë do të jetë i mirë

Do ta heq terrin
Nga nata ime

Atëherë unë nuk do të jem
Vetëm mashtrim

MOS I BESO DIELLIT

Mos i beso diellit
Njeri

Ai topth i zjarrtë
Djersitet në zenit

Ti nga uji je

Gjurmë thellësitë e ligonet
Mbarëso kaltërsinë e detit

Blatoji vargjet e lumit

Njeri
Mos i beso diellit

SYTË QË SHIKOJNË NË MUA

Sytë që shikojnë në mua
Janë të blertë
Dhe plot dritë

Sytë që shikojnë në mua
Janë të thellë
Sa deti të thellë

Sytë që shikojnë në mua
Janë dy gurë para të cilëve përkolem

Dhe nuk e kuptoj pse dridhem

ASTRIT (GAFURR) BYTYÇI
(1975-1998)

U lind në Ferizaj në vitin 1975. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa në vitin 1994-95 filloi studimet në Fakultetin Filologjik në Prishtinë, në degën e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe, ku diplomoi si student i dhjetësheve. Sa ishte student, Astriti u dallua edhe si veprimtar i çështjes së lirisë së Kosovës, për çka ishte në shenjestë të policisë armike. Qysh herët u mor me poezi dhe me shkrime eseistike dhe publicistike. Bashkëpunoj me shumë revista e gazeta shqipe të kohës, ku publikoi shkrimet e veta.

Ishë mbështetës i luftës së UÇK-së dhe me kohë iu bashkua radhëve të saj për të përmbrushur edhe misionin e ushtarit të lirisë deri më 14 dhjetor 1998, kur ra heroikisht në kufirin shqiptaro-shqiptar.

Astriti hyri në historinë më të re kombëtare si dëshmor i kombit. Aktiviteti i Klubit letrar "De Rada" në Ferizaj, "Ora e Astritit" organizohet në shenjë nderimi ndaj veprimitarisë së tij letrare dhe patriotike.

VARRI I ÇUDITSHËM

Teodor KEKO

Në varreza filloj të binte muzgu dhe andej nga thellësia, djathtas, gjithmonë duke ecur diagonal hyrjes kryesore, flakariti një rozë ende e lehtë dhe Llani u kujtua për qiririn e pandezur në xhep, mirëpo as u kthye në kupën e dheut ta ndizte atë qiri e as e futi dorën në xhep ta nxirri. Priti një herë të ndahej nga roja i parcelës C. Nuk e njihet njeriu përballë e s'donte të acarohej me të për punë zakonesh fetare e besty-nish, aq më tepër, që s'po e cyste e nxitonte gjë ta ndizte me vrap qiririn, se kujtesa nuk po i nxirri ndonjë rregull, që thoshte se qirri s'ta ndrit shpirtin, në u ndeztë natën e jo në muzg. Si të ndahem me këtë, po e ndez, e ndau mendjen Llani, pastaj futi dorën në xhep e nxori në vend të qiririt paketën e cigareve, i ra fundit të saj me ca goditje të gishtit të madh dhe ia zgjati tjetrit ciga-ret pa i prekur filtrat me gishtërinj. Mbështet manjak pas pastërtisë roja dhe pse t'ia bënte ters e zehernderin.

-Urdhëro!-i tha me dorë të vendosur në zemër.

Atëherë e vuri re se rojtari ishte si xhind e shenjt bashkë, i shkëllqenit sytë, a thua i kishte bebzat prej fosfori, dhe ta shihte ftohtë, me një mosbesim dijetari mes rrugaçesh. Rojtari e mori cigaren dhe, tek po bëhej gati ta ndizte, e pyeti Llanin, që e futi paketën në xhep pa marrë një cigare për vete, se pse s'e ndezti dhe ai.

-Këtu brenda mureve nuk e ndez dot, -iu përgjigj Llani, -s'ma pranon shpirti. Matanë portës, po, -i tha.

Fjalët e ndërruan rojtarin. Andej djathtas, nën kodër, flakët e qirinje tani ngrohnin qellin dhe varret dukeshin si pemët me perëndim në shpinë. Pastaj edhe ai vetë ngjau në atë sfond dridhës flakësh si monument i errët, pak i kërrusur, a thua mbronte tokën me strehën që i krijonte gjoksi.

-Mirë e ke, -i tha Llanit me një ton të vendosur.

-Është gjynah, po unë e ndiej se më falet. Të vdekurit e kanë lidhur jetën me mua dhe më kanë pranuar me të mirat dhe të këqijat që kam. Pastaj, ai që të mërzit nuk të detyron të mos ngushëllohesh. Mua më ka vrarë zoti tani që, kur shoh gur, them "ti do të bëhesh plakë varri"...

Dukej se atë e vriste ndërgjegjja sa herë e ndizte cigaren brenda në varreza dhe mundohej t'ia mbushte mendjen vetes me çdo formë e mënyrë që ai, vetëm ai, të kuptohemi, nuk po bënte mëkat dhe Llani nuk e gërvishти me plagën e kurorëzuar tashmë, vetëm i tha shpërfillshëm:

-Më duket se e paske një inat me ne të gjallët!

Tjetri u shtrembërua dhe iu dobësua pak drita e syve me flakën e çakmakut.

-Unë me të gjallët inat?! -bëri me një shpërfillje tipike për atë mashkullin e ndershëm e të ofenduar në palcë,



webneel.com

që kërcen i indinjuar e bërtet: "unë të bëj pazar me atë qelbësirë?!"

Ja, kështu u shpreh edhe ai, po Llani nuk e mori vesh tamam nëse rojtari i përcmoi të gjallët, apo pyetjen e tij. I hodhi një vështrim vetëtimthi vetes për të parë sa pis ishte brenda, atje te shpirti, ku merrte ngjyrë çdo vepër e sjellje e tij, po hoqi dorë nga ajo punë. Ç'ta prishte gjakun kot!

-Po që e mirë të ka sjellë këtej? -e pyeti rojtari, pastaj, tek pa çudinë tjetër tepër të lexueshme në portret të Llanit për atë "ç'e mirë në varreza?", shtoi se e mira më e madhe është të nderosh të vdekurin.

-Ata as shohin, as dëgjojnë, -bëri duke hapur dorën e djathtë drejt varreve të errëta tashmë, -domethënë, e bën nderin se je njeri që di të nderosh e jo se ta lyp interesil.

Kurse sytë i ndritnin edhe më. Duket, po bie nata tamam, mendoj turbull Llani, kurse me gojë tha shkoqur:

-Duam të ndërtojmë një varr dhe më ka dërguar mua shtëpia të interesohem...

Ku e njeh Krenarin ti, trishtoi me vete Llani, çfarë drite ishte, si sytë e tu e kaluar një mijë herë, pastaj u përmend nga pyetja e ftohtë e tjetrit, se ç'moshë kishte i vdekuri, dhe iu

përgjigj gati po aq ftohtë:

-7 vjeç!

Nuk dëshironte të fliste me këtë shpirtkazmë për engjëlin e vogël, për Krenarin e mrekullushëm që iu dilte për natë në èndërr, sepse do ta fyente kujtimin e tij deri ku s'mbante më. E ku kishte ndjenja ky bari varresh? Gur i qenë bëre me kohë dhe, po t'ia ngulje sytë, si varr të dukej me atë flakën në supe. Mirëpo s'i hyri inati plotësisht, sepse e shtangu të gjithin e ia ndaloj gjithçka në mes zëri i lagur nga një ngashërim i brendshëm i rojtarit:

-Nuk i bëhet varr atij, o njeri!

-Pse? -u habit Llani dhe u drodh nga ideja se tjetri duhet të që përlotur, përderisa sytë nuk i shkëllqenin më si pak çaste më parë.

-Po nuk i takon tokës ai, është fëmijë, -shpjegoi tjetri zëulët, gjithë ashtu i ngashëryer e i trishtuar.-

Ai është i pastër, -shtoi pastaj më qetësisht, -dhe pastërtia i takon qillit, se bëhet diell e ajër e jetë!

Llani nuk u lidh krejtësisht nga kjo logjikë, rrinte e shihte si debil flakën e qirinje në supet e rojtarit, pastaj kundronte Krenarin, ylberin mahnitës, pastaj dhe diellin dhe mësuesin e materializmit në shkollë, që thoshte se sendet përbëhen nga

materia, dhe befas filloj të besonte vërtet se këto mrekulli, si dielli dhe oksigjeni, ylberi dhe bora nuk mund të krijohen nga materiale ordinare e të rëndomta, që përbëjnë, fjala vjen, spinaqin, ose karrocën e plehrave.

-Po si t'ia bëjmë, sipas teje? -e pyeti Llani, -ta lemë pa varr? Ai s'ishte cigan!

Ra një heshtje e rëndë, dukej që tjetri nuk dëshironte të përgjigjej, ose u ndodh ngushtë nga pyetja e drejt-përdrejtë e që s'pranonte asnjë lloj kompromisi, dhe u kollit më shumë nga mëdyshja, sesa nevoja e trupit. Llani ia ndjeu një marrje fryme të plotë e të thellë dhe tha me vete se rojtari tani do t'i përgjigjej, pastaj e pa menjëherë si u drodh e u derdh në shpatullat e tjetrit ajo flakë qirinjsh, që dukej sikur ai e thithi brenda gjoksit me atë frymëmarrje.

-Ja si them unë, -foli më në fund rojtari.

Tani ishte tamam natë.

-Njeriu u mësua prej kohësh t'i bëj varr edhe të mirit, edhe të keqit. E disa të poshtët prehen këtu, se po ndot gojën me të ikurit, që s'shahen? Plot! Ama, të gjithë kanë varre! Njerëzit e dinë këtë, se vetëm budallenj nuk janë. Kështu që i kapi zakoni i ndërtimit të varrit si lamtumirë e fundit me të vdekurit, dhe, me t'ia ndërtuar banesën e fundit, nuk shkelin më në varreza. Është hesap kjo punë: e do varrin, merre!

Tani, ti në punën tënde, unë në punën time. Me një fjalë, ku jemi parë bashkë! Ju çunit bëjini jo një varr, po një monument! Unë them, të mos e harroni, se ka qenë i pastër, i pamolepsur nga pisllëqet!...

Dhe Llani e porositi varrin të madh e të rëndë, aq sa të vinte keq kur men-doje se mund t'ia shkallmonte arkivolin dhe eshtrat Krenarit të vogël, një varr i çuditshëm, prej graniti të hirtë, vetëm pllakën ia porositi prej mermeri të zi dhe në atë natë kërkoi të shkruheshin me shkronja të arta ato fjalë që e bënë varrin të çuditshëm në atë vend ku s'ekziston çudia, siç është varreza publike, dhe që e kthyen varrin në vend pelegrinazhi, eliksir ngushëlli-mi për çdo humbje tragjike: "Këtu prehet Krenar Halimi, 1981-1988, ka qenë i pastër, i pamolepsur nga pisllëqet". Ky varr i kushtoi Llanit 1250 lekë, po të kihet parasysh se 780 lekë iu faturua komplekt varri, kurse me 470 Llanit iu desh të qeraste dy herë drejtorin e ndërmarrjes së riparimeve, për ta marrë përsëri në punë mjeshterin varrbërës, i cili u pushua në vend nga puna për shkrimin pa pikë përgjegjësie të atyre fjalëve ofenduese për ne njerëzit, në pllakën e varrit. Në të vërtetë, ai edhe mund ta hidhte lumin pa u lagur, sikur të pranonte propozimin e drejtorit të funeraleve për prishjen e shkronjave të pllakës, po nuk e bëri këtë.

Vetëm tundi kokën dhe tha:

-Unë nuk kam gënjer, ai i pastër ishte! Në qoftë pis ndonjëheri nga ne, qoftë me shëndet, e atë djalin ta lërë të qetë në botën e vet!

Kama Sywor KAMANDA



GJAK TOKE

O racizëm! brengë shqetësuese
Për bastardët mosmirënjosës
Kush e urren zezakun
Turpëron origjinën e vetë!
Rrënjen e para-ligjérimit
Imagjinarja zgjohet
Nga thellësitë e trupit të zi.
Shpirt Perëndish infiltruar
Në materie ngjyrosur argjilë
Që del n'horizont genësi kozmike,
Zezaku u metamorfozu
U integrua në çdo intimitet.
O nur poetik,
Për legjendat e përjetësisë mendoj
Mëdyshjet e pafundësisë
Zbulimet e absolutes,
Mbrojtësit rrenacakë
T'orakujve dhe të profetëve!
O gjak toke!
Univers fjalësh të harxhuara,
Tani jam vetë rrënja
E kronikave tua të shenja.
Yjet m'i ushqejnë brigjet
Dhe lërojnë prani në mua.

DUART HYJNORE

E pashë rrufenë
Të pëlcet me mijë shkrepitma
Aty ku dashuria në natën e vakët
Fshihej nga rrebeshi.
Përrenjtë me revoltë
Trandnin pasione,
Pendime dhe emocione
Me rrënoja të çuditshme.
I pashë duart e Isiès
T'i udhëheq fëmijët e humbur
Larg fatit të keq
Vdekjes dhe terri nave.
O përbetim arnshimi i hijes time të vdekshme!
Dënesja m'i përzien harbimet
Me gjatësitë e breshjeve.
O himni njerëzor i Shpirtit të pavdekshëm,
E kam zgjatur veshin drejt rënkimive tona
Robëresha të vijëzimeve t'mija!
Befas, qetësia e njeriut
E burgosur jehone provash
Më ka shkundulluar në zgjim vullkanesh
Me dridhmat e kozmosit.

GJAKU ARGJILOR

Ah! Shpirt origjine,
Ëndrra në shekuj
Shtrinë jetën tej n'Përjetësi.
Roja hap dyert
Në sfond bote të padukshme
Aty ku argjila i artit
Përzihet me fjalët e sanataditës.
Zezak, o Paraardhës i njeriut,
Perënditë të mbajnë Profet!
O ti që do krijosh njerëzimin shumësi,
Ngjyrash lloj-lloj
Rërat shtegtare lakmojnë
Tempujt, legjendat
Dhe vendet e shenja t'namit tënd.
O Zezak! Ti je vetë fillimi,
Por edhe fund ëndrrë i Perëndisë.
Ti u përvodhë në matricën e tokës
Kur puhia edhe e pakrijuar n'erë
Trandi malet.
Qielli i hapur n'agime ditësh
Sérish u mbyll në filigran t'gjakut tënd.

NILI

O Nil, burim hyjnish!
Ne i kërkuan frutat e epshit
Aty ku flautet dhe këngët,
Në dëgjim zemrash,
Krijonin quellin e ri
Për tënden dashuri. Një gjuhë mike
Na dhuroi një frymë shprese.
Hëna e struktur pas reve,
Na i vijëzonte hijet
Me filigran agu
Në mes palmash.
Larg vullkanit sqimë,
E thithëm aromën e erës,
Duke soditur brigjet e shkreta
Fjalën e harruar. O mall,
Dyshimi sjell provën
Nga zhgënjimi i fjalëve!

RRUGA E PROFETËVE

Varret dhe piramidat e Mbretërvë tanë
U vodhën, u përdhosën e u shkatërruan
Ndërsa erërat dhe grabitqarët
I shkulët obeliskët.
Ne s'pari e nisëm erën e syrgjynit
Nga përndekja jonë luanët,
Leopardët, deshët dhe zhuzhingat
E ndoqën rrugën gjatë me vegulli magjepsur
Plot hidhërim, e gjerryer vrer.
Bantu! O populli im! Kush na i di rrënjet?
Disave do t'ju thonë:
"Ata vijnë nga burimi i Nilit!
Të tjerëve, që ëndërrojnë për tokën begati,
Një erë shajnim i profetëve t'padukshëm vete,
Me fëshféri valëve përmes pulëbardhave:
"Dëshmitarë t'orës parë t'njerezimit,
Krijues të Nybisë dhe t'Egjiptit,
Gjatë sprovës kur thahej Saharaja,
Qofshin të mallkuar".

GJAK NJERIU

Zbutës të brigjeve të Nilit
Bantutë duke shkelur tokat hyjnore,
Ecin drejt përjetësisë,
Përqafonjë dritën e yjeve të larguar
Dhe nga thellësia e greminës gulfim
Sollën gjak jete njeriut t'hyjnizuar.
Kur erdhë ai që e pritnin të gjallët,
Rrethuar gjithandej me meteore,
Diellit u struk në thellësinë e shikimit t'largët,
Profetët kthyen kokat mënjanë
Ndërsa mbretërit e bënë poet zemre
Priftërinjtë u tallën
Plot porosi për popujt.
Fjalëshunë të pashtershëm t'fjalës së shenjtë
Ati i bënë pritje hata:
Fundë i predikimeve.

GJAK KOZMIK

O gjak kozmik, rrënojë agimi original!
Koha ma ka zbutur frymën në thellësi shpirti.
Çastet e mia ndeshen n'erë përjetësie.
O Muntu, mishërim i diellit!
Në ijët tua kam matur qëndrimin e vdekjes.
Njeri i zbritur nga yjet e largëta,
I ndjej dënesjet e filadit të mbrëmjes.
Rojtar nuskash e shpjegues enigmash,
Ja ku më ke edhe ndërtimtar me gurë
Në tokë shtegtimi.

XIXA

Obelisk i qytetit të Diellit,
Përjetim i fuqishëm qëndrimi vertikal,
Që tërheq vëzhgimin e dritës hyjnore,
Hajmali që nga tempujt përzë
Forcat e errëta
Ti je në vijën tonë.
Kështu, je lidhje njeriu
Me forca kozmike.
Shpirti i origjinës rri te ti
Që shpirtat na i çon n'amshim.
Shiu në tokat tona
Grurin e mugullon me dashuri
Po aq të dhembshur sa kujtesa jonë.
O gjak Perëndish!
O gjak Faraonësh!
Po vigjiloj përmbi xixë
Të rilindjes bantu.

VRASJA E ARTISTIT TË VËRTETË

Arti për art, zbavitja e një artisti të vetmuar, është me të drejtë arti artificial i një shoqërie të rreme e abstrakte



Albert KAMY

Sot vlera më e përgojuar është ajo e lirisë. Disa njerz të cekët (gjithmonë kam menduar se ka dy lloj mençurish, mençuria e zgjuarsia

e trashë) kanë nxjerrë doktrinën se ojo nuk është tjetër, veçse një pengesë në rrugën e progresit të vërtetë. Por ka qenë e mundur të thuhen budallallëqe kaq të mëdha, sepse për njëqind vjet shoqëria tregtare e ka përdorur lirinë në mënyrë përashtuese e të njëanëshme, e ka konsideruar atë si një të drejtë e jo si detyrë, dhe nuk ka pasur frikë të vendoste një liri në parim në shërbim të një shtypjeje që mbretëronte në të vërtetë. Duke u nisur nga ky fakt, përsë të habitemi nëse kjo shoqëri nuk i ka kërkuar artit të jetë një instrument çlirim, por një ushtrim pa pasoja të mëdha dhe një zbavitje e thjeshtë. Tërë ajo botë që karakterizohet nga kokëçarjet për shkak të parave, por mbi të gjitha nga taksiratet për shkak të dashurisë, gjatë shume vitesh ishte e kënaqur me shkrimtarët e saj mondanë dhe me artin më pa vlerë që mund të ekzistonte, ai për të cilin Oskar Uaildi, duke menduar përveten e tij përparrë se të

kishte njohur burgun, thoshte se vesi më i keq ishte të qenit i sipërfaqshëm. Fabrikuesit e artit (ende nuk kam thënë artistët) e Evropës borgjeze, përparrë pas 1900, kanë pranuar në këtë mënyrë papërgjegjshmërinë, pasi papërgjegjshmëria nënkuptione një shkëputje rraskapitëse nga shoqëria e tyre (ata që janë shkëputur me të vërtetë quheshin Rembo, Niç, Strinberg dhe të gjithë e dimë shumë mirë çmimin që kanë paguar). Teoria e artit për art, zbavitja e një artisti të vetmuar, është me të drejtë arti artificial i një shoqërie të rreme e abstrakte. Kurorëzimi i tij i logjikshëm është arti i salloneve ose arti tërësht formal, i cili ushqehet me preciozitate e abstraksione dhe që ka si rezultat shkatërrimin e çdo realiteti. Disa vepra, ashtu si dhe disa njerz të mrekullojnë, por në të njëjtën kohë ka edhe shumë shpikje të ndyra që

dëmtojnë shumë të tjerë. Si përfundim, arti kriohet jashtë shoqërisë dhe shkëputet nga rrënjet e saj të gjalla. Pak nga pak, ndonëse në majë të suksesit, artisti është vetëm, ose të paktën njihet nga kombi i tij vetëm me ndërmjetësinë e shtypit të gjerë apo radios, që do të jepin për të një idë të përshtatshme e të thjeshtuar. Me specializimin e artistit, bëhet i nevojshëm edhe vulgarizimi. Kështu, shumë e shumë njerz do të kenë përshtypjen se e njohin një artist të caktuar të epokës sonë, meqë kanë mësuar nga gazetat se ai rrit kanaria ose se nuk martohet asnjëherë përmë tepër se gjashtë muaj. Sot të jesh i famshëm do të thotë të admirojnë ose të tëurrejnë, pa të lexuar. Çdo artist që do të jetë i famshëm në shoqërinë tonë, duhet të dijë se nuk është ai që do të jetë i tillë, por dikush tjetër me emrin e tij, i cili nuk do të ketë asgjë të përbashkët me të dhenoshta do të vrasë një ditë brenda tij artistin e vërtetë.

MBI LEXIMIN

FJALET OSE IMAZHET

Orhan PAMUK

